



***ANALIZË E KUADRIT LIGJOR QË GARANTON EDUKIMIN
E FËMIJEVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA
NE KUSHTET E ARSIMIT GJITHPERFSHIRE***

RAPORT STUDIMOR

*Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
me mbështetjen dhe në bashkëpunim me Save the Children, në Shqipëri*

**ANALIZË E KUADRIT LIGJOR QË GARANTON
EDUKIMIN E FËMIJEVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA
NE KUSHTET E ARSIMIT GJITHPERFSHIRES**

RAPORT STUDIMOR

*Përvojë rajonale, arritje, sugjerime
dhe sfida për të ardhmen*

*Realizuan studimin:
Zela Koka, MA.Valentina Haxhiymeri, Dr. Marita Nika Flagler, Fatmir Bezati*

*Përgatiti raportin:
Valentina Haxhiymeri*

Tiranë, Mars 2005

**Fondacioni Shqiptar per te Drejtat e Personave
me Aftesi te Kufizuara. (FSHDKPAK)**

Rr. Mujo Ulqinaku, Nr 26, Tirane

Tel +3554 266 892/ 269426/

e-mail: adrf@icc.al.eu.org/

www.adrf.org.al

SAVE THE CHILDREN - NË SHQIPËRI

Rr. Komuna e Parisit; L8, P 1 Maji, Vila Lami,

P.O. Box 8185 Tirane

Tel: +355 4 2361840; 261929,266277

Fax +355 4 263428

e-mail: savealbania@savealbania.org

www.savealbania.org

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	5
1. Kuptimi bashkëkohor për gjithpërfshirjen në arsim dhe historia e implementimit të saj në shkollën shqiptare	7
2. Kuadri ligjor ekzistues që garanton arsimimin e fëmijëve me AK në kushtet e arsimit gjithpërfshirës	11
3. Projekti “Arsimi Special i Integruar” – “laboratori” që vuri në provë efektivitetin e kuadrit ligjor ekzistues për arsimin gjithpërfshirës	14
4. Situata aktuale e zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës në rajonet Librazhd dhe Elbasan	17
5. Mendime të specialistëve të edukimit rreth efektivitetit të zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës	35
6. Përfundimet e studimit	38
7. Fushat e ndërhyrjes për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës	40
8. Referencat	45
9. Grupi i studimit	46

HYRJE

*Një ndër kërkesat e shtruara qartë për vendet që kërkojnë të anëtarësohen në Komunitetin Europian është edhe **përmbushja e të drejtës për arsimim të të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga ... aftësia e kufizuar që ata kanë**. Për shoqërinë shqiptare, plotësimi i kësaj kërkesë ende përbën një shqetësim të madh. Pavarësisht nga fakti se shkolla jonë ka vite që është përfshirë në një sërë procesesh reformuese të cilat vazhdojnë të synojnë ridimensionimin e funksioneve të saj edukative dhe shndërrimin gradual të saj në shkollë “për të gjithë”, rezultatet e deritanishme akoma nuk i afrohen standardeve dhe kërkesave të KE.*

*Në këto rrethana, intensifikimi i përpjekjeve të përbashkëta për të përshpejtuar dhe thelluar më tej reformën gjithpërfshirëse në arsim që nënkupton në vetvete sigurimin e barazisë arsimore për të gjithë nxënësit, përfshi edhe ata me AK, përbën një detyrë sa të rëndësishme aq edhe të domosdoshme. Orientuar nga kjo ide, në muajt dhjetor 2004 dhe janar 2005, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, financuar nga “Save the Children”, ndërmori një studim rajonal që synoi të zbulojë hapat konkrete lidhur me **zbatimin e ligjit për arsimimin e fëmijëve me AK në kuadër të arsimit gjithpërfshirës**, si dhe të nxjerrë në pah **problemet që pengojnë realizimin e tij në mënyrë të plotë**. Studimi u shtri në zonën e Librazhdit, Elbasanit ku vitet e fundit është implementuar projekti i mirënjohur “Arsimi Special i Integruar” që kontribuoi në krijimin e përvojës së parë të arsimit të fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor që garanton vazhdimësinë e kësaj përvoje.*

Për të arritur qëllimet e tij, studimi u fokusua jo vetëm në shkollat e zakonshme por edhe në institucionet e tjera që drejtojnë dhe mbështesin veprimtarinë edukative të këtyre shkollave. Në këtë mënyrë, pjesë e studimit u bënë nxënësit me AK, bashkëmoshatarët e tjerë normalë, mësuesit e tyre, prindërit e fëmijëve me AK, specialistët e shërbimit psikologjik, drejtuesit e shkollës, drejtues dhe inspektorët të DAR dhe ZA, punonjës të ZSHS pranë bashkisë së rrethit, pedagogë dhe studentët të fakulteteve që përgatisin mësues, specialistë të edukimit në MASH, etj. Me synimin për mundësinë e replikimit të projektit në qytetin e Tiranës, në studim u përfshinë dhe Drejtoria Arsimore Tirane si dhe zyra e Shërbimit Social në Bashkinë Tirane.

Gama e madhe e subjekteve të përfshira në studim dhe veçoritë tyre lidhur moshën, profesionin, rolin, nivelin arsimor dhe funksionin përkatës, diktuan para grupit të studimit përdorimin e metodave të larmishme për grumbullimin e informacionit të nevojshëm. Në këtë kuadër, u bë kujdes që metodat studimore të përputhen me qëllimet specike të studimit dhe karakteristikat e subjekteve sipa çdo grup-moshe të veçantë. Me fëmijët me AK u përdor më dëndur vëzhgimi në mjediset mësimore dhe në oborr të shkollës, bashkëbisedimi në grup, përfshirja në detyra akademike dhe vizatimore, dhe më rrallë, u përdorën intervistat e drejtpërdrejta. Me bashkëmoshatarët e tyre normalë u përdorën metoda e vëzhgimit, përfshirjes në detyra vizatimi dhe pyetësorët. Me mësuesit, prindërit, psikologun, drejtuesit e shkollës, studentët dhe stafi akademik i UE u përdorën anketimet, intervistat e drejtpërdrejta dhe ato në telefon. Në të njëjtën mënyrë u veprua edhe me inspektorët e DAR, ZA, ZSHS dhe MASH. Pas përpunimit në % të të dhënave të mbledhura dhe shqyrtimit analitik të fakteve të dokumentuara, studimi përfundon me një raport me shkrim.

Përmbajtja e raportit ndjek linjën logjike të vetë studimit. Ai përbëhet nga tre pjesë të rëndësishme. Në pjesën e parë gjen shpjegim kuptimi bashkëkohor i gjithpërfshirjes në arsim dhe

historia e implementimit të saj në shkollën e zakonshme shqiptare, si dhe përmirësimet në vijimësi të kuadrit ligjor që garantojnë arsimimin e fëmijëve me AK në kushtet e arsimit gjithpërfshirës. Kjo pjesë përbën bazën teorike ku u mbështet studimi dhe thekson faktin se në Shqipëri ekziston një përvojë e suksesshme e arsimit gjithpërfshirës, dhe një kuadër ligjor në përgjithësi i kompletuar, që siguron vazhdimësinë e kësaj përvoje. Pjesa e dytë e studimit merr përsipër t'u përgjigjet pyetjeve se si paraqitet aktualisht situata gjithpërfshirëse dhe në ç'masë po vepron ligji për arsimin gjithpërfshirës? Kjo pjesë përpiket të përmbush qëllimin pse u ndërmorë studimi, dhe bën një analizë të hollësishme mbështetur në fakte konkrete rreth problemeve të shkollës së zakonshme lidhur me zbatimin e ligjit për edukimin e fëmijëve me AK në kushtet e arsimit gjithpërfshirës.

Përfundimet paraprake të kësaj pjese të studimit u bënë çështje diskutimi në një tryezë të rrumbullakët me specialistë të edukimit në nivel ekspertësh, duke i hapur udhën realizimit të qëllimit final të studimit, përcaktimit të fushave të ndërhyrjes për të rritur efektivitetin në zbatimin e ligjit për arsimin gjithpërfshirës. Kjo çështje përbën pjesën e fundit të raportit që ndiqet nga rekomandime modeste për të bërë ndryshimet e duhura në të ardhmen.

Për përgatitjen e raportit u shfrytëzuan botime, artikuj studimor, raporte vlerësimi, dhe dokumente të tjera të rëndësishme. Në përmbajtjen e raportit zënë vend edhe ilustrimet konkrete që shprehin përjetime të fëmijëve me AK dhe prindërve të tyre. Për të rritur vlefshmërinë e jashtme të studimit, raportit i janë bashkangjitur disa nga formatet e përdorura në intervista, anketime dhe pyetësor. Këto dhe të tjera, janë përfshirë në rubrikën SHTOJCA.

Së fundi, grupi i studimit shpreh falenderimet e sinqerta për të gjithë ata që dhanë ndihmesën e tyre në procesin e studimit dhe në finalizimin e këtij raporti.

1. KUPTIMI BASHKEKOHOR PER GJITHPERFSHIRJEN NE ARSIM DHE HISTORIA E IMPLEMENTIMIT TE SAJ NE SHKOLLEN SHQIPTARE

Gjithpërfshirja në arsim është një proces kompleks i cili parasëgjithash, ka nevojë të njihet dhe pastaj të vihet në lëvizje.

Sipas një kuptimi më të moderuar, gjithpërfshirja ndryshon nga integrimi. Ajo ka të bëjë me diçka më shumë se sa thjesht t'i pranosh fëmijët me nevoja të veçanta brenda klasës së rregullt. Pranimi në vetvete është një proces më i lehtë dhe nuk kërkon ndryshime në sistem. Ndërsa, përfshirja kërkon të bëhen ndryshime rrënjësore. Zakonisht këto ndryshime fillojnë me kuadrin ligjor për arsimimin dhe pasojnë me angazhimin e përbashkët të autoriteteve arsimore dhe të vetë shkollës, për të rritur pjesmarrjen e të gjithë nxënësve në programet mësimore, për të siguruar shërbime mbështetëse të mjaftueshme, personel të kualifikuar, mësues me trajnimin e duhur, dhe mbi të gjitha, për të krijuar një atmosferë shkollë mikpritëse dhe të sigurt. (*“Unë jam si ju” fq. 59. Prill, 2003*). Një shkollë e tillë kultivon kulturën e bashkëpunimit, përkujdesjes dhe respektit reciprok. Ajo orientohet nga ideja se diferencat dhe diversiteti midis nxënësve nuk mund të shihen më si pengesa për zhvillimin dhe të nxënësve, por si cilësi që duhen vlerësuar me përparësi, duke lejuar kështu që çdo nxënës, përfshi edhe ata me nevoja të veçanta (fizike, mendore, sociale dhe emocionale), të zhvillojnë aftësitë e tyre përkrahë moshatarëve të tjerë.

I parë nga ky kënvështrim, gjithpërfshirja në arsim cilësohet si mjeti më i favorshëm që krijon shanse të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët, me apo pa aftësi të kufizuara, shmang qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, nxjerr në pah vlerat personale të gjithësecilit, për të cilat një shoqëri e emancipuar ka shumë nevojë, dhe lehtëson integrimin social të tyre në jetën e ardhshme si të rritur. Përveç dobisë arsimore, edukimi gjithpërfshirës i kushton shumë më pak shoqërisë njerëzore. Për këto arsye dhe të tjera, shumë vende të zhvilluara të botës e kanë përqafuar herët praktikën gjithpërfshirëse dhe sot janë duke reflektuar vlerat e shumfishta që burojnë prej saj.

Nga na tjetër, përvoja e këtyre vendeve, ka treguar treguar se *rruga drejt gjithpërfshirjes së plotë nuk është dhe aq e lehtë!* Një studim i UNESCO-s në vitin 1996 për arsimimin e personave me nevoja të veçanta dhe nivelet e gjithpërfshirjes së tyre në shkollat e zakonshme (në 52 vende të botës) tregoi se *asnjë nga vendet e marra në studim (përfshi edhe ato vende relativisht të pasura dhe të zhvilluara nga pikpamja arsimore), nuk kishin arritur gjithpërfshirjen totale (Unë jam si ju - fq. 60. prill 2003)*. Por pavarësisht nga niveli aktual i gjithpërfshirjes, këto vende janë shumë më përpara në këtë drejtim se sa vendi ynë!

Gjithpërfshirja arsimore në Shqipëri ende përbën një proces në hapat e tij të parë. Nxitja dhe mbështetja e këtij procesi, kryesisht ka ardhur nga organizmat jo qeveritare lokale dhe ndërkombëtare si: Children's Aid Direct (CAD), UNICEF, Save the Children, MEDPAK, Shoqata Kombëtare e Handikapëve Mendorë, FSHDPAK, Ndihmoni Jetën, Organizata e te verbërve, etj. Ndërkohë, politikat qeveritare në këtë aspekt, kanë qënë të pakta, ndërsa praktikat gjithpërfshirëse mjaft të ngadalta. Gjithësesi, në 7 vitet e fundit mund të konstatohet lehtësisht se është rritur në mënyrë progresive vetëdija dhe përpjekja e përbashkët për të pranuar dhe instaluar arsimin gjithpërfshirës.

Merita më e mëdhe në këtë drejtim, i takon pa dyshim, organizmave joqeveritare të lartpërmendura, të cilat përveç përkujdesjes së drejtpërdrejtë social-ekonomike që kanë treguar ndaj personave me nevoja të veçanta, nuk kanë rreshtur për asnjë çast përpjekjet e tyre për të ndikuar në përmirësimin e politikave dhe legjislacionit shqiptar që garantojnë të drejtën e çdo personi (përfshi edhe ata me AK), për t'u arsimuar dhe për të pasur një jetë normale e me dinjitet. Projektet e secilës prej këtyre organizmave, edhe pse ndonjëherë të pabashkërenduara mirë mes njëra-tjetrës, përbëjnë shtratin mbi të cilin lindën idetë e para për arsimin gjithpërfshirës në Shqipëri dhe ku u mbështet ligjërisht inicjativa për futjen e tij në proces.

Në fakt, *ato pak projekte që i paraprinë historisë gjithpërfshirëse në arsimin shqiptar, fillimisht*

propoganduan dhe aplikuan integrimin e fëmijëve me AK në mjediset e zakonshme edukative. Në këtë linjë, vlen të përmendet projekti i shoqatës Children's Aid Direct (CAD) në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Tiranës dhe shoqatën kombëtare të prindërve "Në Ndihmë të Handikapeteve Mendore", i zbatuar në vitet 1994-1996. Përmes këtij projekti, i cili pushoi së ekzistuari me mbarimin e fondeve, u arrit të integrohen disa fëmijë me AK në disa kopshte të Tiranës. Po në këtë periudhë u integruan 11 fëmijë të moshës shkollore në shkollën e qytetit të Librazhdit (FSHDPAK-Nano, 2002).

Më pas, në vitin 1997-1998 Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve në Tiranë, ndërmori një projekt që synoi integrimin e fëmijëve me AK (probleme dëgjimore, autizëm, hiperaktivitet, me vonesa në zhvillimin psikomotor, me probleme të foluri, etj.) në shkollat e zakonshme. Aktualisht këta nxënës vazhdojnë shkollën e përgjithshme pa ndonjë mbështetje të jashtme (Nano, 2002).

Paralelisht me praktikat e para integruese, u zgjua interesi për identifikimin e fëmijëve me AK në shkallë vendi dhe për njohjen reale të problemeve të tyre lidhur me arsimimin.

Sondazhi i organizuar nga FSHDPAK në 1998, i fokusuar në visibilitetin e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe veçanërisht të fëmijëve me AK, tregoi se janë të paktën 9 000 fëmijë me aftësi të kufizuara të theksuara dhe (e diskutueshme) deri në 11 000 të tjerë me aftësi të kufizuara të lehta, të cilët nuk kanë marrë shërbime nga OQ-të dhe OJQ-të (Unë jam si ju, fq. 32. Prill, 2003). Ky studim shpjegoi gjithashtu edhe arsyet e padukshmërisë së PAK. Argumenti qëndron në faktin se familjet shqiptare preferojnë më tepër etiketimin "i sëmurë" për të afërmit e tyre me AK, duke ju ofruar atyre kujdes brenda familjes, por edhe duke i fshehur ose përjashtuar nga jeta normale, me qëllim që t'i shpëtojnë frikës së të qenit "objekt diskriminimi dhe talljeje" (Unë jam si ju, fq.34. Prill 2003).

Studime të tjera në vijim, të shoqëruara edhe me statistika, artikuj, botime, etj. sollën fakte nga realiteti shqiptar lidhur me arsimimin e fëmijëve me AK.

Në këtë kontekst, studimi i Prof. Dr. Virxhil Nano (botuar në revistën pedagogjike, nr. 1-2, v. 2000), dëshmon se:

"... gati 20 % e fëmijëve në periudhën e shkollimit manifestojnë vështirësi serioze apo nevoja speciale për të nxënë. Ndërkohë, ... institucionet që ofrojnë shërbime të përshtatshme nuk arrijnë të plotësojnë as 2-3 % të nevojave në shkallë vendi. Shumica e qyteteve dhe fshatrave mbeten të pambuluara me shërbim arsimor të përshtatshëm për fëmijët me AK".

Ndërsa studimi i Prof. As. Dr. Ardian Turku, në vitin 2001, përshkruan si më poshtë gjendjen në institucionet speciale:

"Institucionet e specializuara për arsimimin e fëmijëve me AK manifestojnë një ulje të efektivitetit të punës që rezulton jo vetëm nga izolimi social që ju bëhet fëmijëve në to, por edhe nga ... zhvillimi i programeve mësimore shpesh jo të përshtatshme, mungesa e një kualifikimi të vazhdueshëm të stafit që ofron shërbime edukative dhe terapeutike, bashkëpunimi i bobët me strukturat komunitare, prezenca e një teknologjie të pamjaftueshme për mësimdhënien cilësore, etj."

Shifrat e deklaruara nga sondazhi i FSHDPAK-së, si dhe gjendja e rënduar e arsimimit të fëmijëve me AK konfirmuar nga studime eksperte, ndikuan në rritjen e vetëdijes profesionale për të sjellë ndryshim në fushën e edukimit special, si dhe përforcuan idenë për gjetjen e nje forme arsimore më të përshtatshme dhe më masive për arsimimin e fëmijëve me AK.

Në kontekstin e këtyre përpjekjeve për të sjellë zhvillime të reja arsimore, nis fazën e tij të parë projekti "Arsimi Special i Integruar" (2000-2001), i cili u ideua dhe u zbatua nga shoqata MEDPAK me qendër në Librazhd, ndërsa financimi u krye nga UNICEF, Movimondo (OJF Italiane) dhe CAD. Me ndihmën e specialistëve të edukimit projekti arriti të përfaqësojë me sukses modelin bashkëkohor të arsimit

gjithpërfshirës me përvojën tonë të edukimit në përgjithësi, dhe atë special, në veçanti, duke gjeneruar në këtë mënyrë një *variant shqiptar të gjithpërfshirjes në arsim*. Zbatimi i këtij varianti në zonën e Librazhdit, mundësoi të gjithë fëmijët me AK (mendore, sensore, motore, sociale dhe emocionale) dhe vështirësi në të nxënë të këtij rajoni, që të vazhdonin shkollën pranë qendrave të tyre të banimit. Rezultatet e arritura në fazën e parë të projektit, u bënë shtysë për inicimin e dy fazave të tjera të tij (2001-2002; 2002-2003), që synuan zgjerimin e përvojës së fituar edhe në rajonet e tjera të afërta (Elbasan dhe Peqin).

Në një raport vlerësimi të ndërmarrë nga UNICEF dhe MASH që synonte monitorimin e arritjeve të veprimtarisë trevjeçare të projektit “Arsimi Special i Integruar” (dhjetor 2003) konkludohet se “*Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në këtë projekt ndikoi dukshëm në përmirësimin e mundësive të tyre për të nxënë, në rritjen e aftësisë për t’u shoqëruar dhe në zotërimin e aftësive për jetën. ... Nga pikëpamja financiare, kostoja e edukimit të çdo nxënësi të përfshirë në projekt rezultoi 16,2 herë më e vogël se kostoja mesatare e edukimit të fëmijëve me AK në shkolla e institucione speciale... Në të njëjtën kohë, projekti kontribuoi në zhvillimin e programeve kualifikuese dhe kooperuese mes hallkave të ndryshme që mundësojnë arsimin gjithpërfshirës”.*

Përmes projektit “Arsimi Special i Integruar” u arrit më në fund të bëhet realitet gjithpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme pranë vendbanimeve të tyre.

Në studimin sasior-cilësor mbi përgatitjen e shkollës shqiptare për të ecur më tej në proceset integruese që u zhvillua në Tiranë dhe Durrës nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), një organizatë joqeveritare që ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e së drejtës për arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë të vecante për aprovimin e dispozitave normative, kapitullit mbi arsimin special, doli në pah fakti se integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk përben një dukuri masive. Qëndrimet e mësuesve dhe të nxënësve janë pozitive, dashamirëse dhe njerëzore, por shkollat nuk kanë akoma një politikë të qartë për realizimin e procesve integruese. Studimi tregoi se ka ndryshime pozitive në qëndrimin e njerëzve në përgjithësi dhe të mësuesve në veçanti për realizimin e proceseve integruese, gjë që përben një bazë të mirë për realizimin e politikave arsimore gjithpërfshirëse. (Shkolla shiptare drejt proceseve integruese - Nano, 2002)

Në përgjigje të këtyre fakteve dhe eksperiencës tashme të pakontestueshme për nga suksesi të projektit “Arsimi Special i Integruar” Librazhd, MASH aprovon *Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar* (dhjetor 2002) ku përfshin për herë parë konceptin e arsimit gjithpërfshirës dhe një sërë rregullash për ta bërë të mundur zbatimin e tij në praktikë. Me aprovimin e Dispozitës Normative (dhjetor, 2002), jo vetëm u plotësua vakumi ligjor i deriatëhershëm për arsimin gjithpërfshirës, por më e rëndësishmja është se u hap drita jeshile për futjen e tij në sistemin arsimor të detyruar.

Në korrik 2003, nis projektin shoqata “Ndihmoni Jetën” financuar nga Save the Children që synon krijimin e një përvoje të ndërhyrjes edukative gjithpërfshirëse më të hershme se sa arsimi i detyruar fillor. Në këtë kuadër, projekti ka vendosur 31 fëmijë me prapambetje të lehtë mendore, epilepsi, autizëm, vështirësi të sjelljes dhe vështirësi emocionale në 12 kopshte të tre njësive bashkiake në Tiranë (Njësiti 1,2,3) dhe për të zgjeruar këtë përvojë ka trajnuar edhe 80 edukatore dhe drejtuese kopshti.

Hapi tjetër i Qeverisë Shqiptare dhe tepër serioz në drejtim të gjithpërfshirjes, është hartimi i *Strategjisë Kombëtare për PAK* (aprovuar në 2004). Mes të tjerash, në këtë plan-veprimi qeveritar, zënë një vend të rëndësishëm edhe politikave për arsimimin e fëmijëve me AK, të cilat në avancë synojnë:

- shtrirjen graduale të arsimit gjithpërfshirës, duke e filluar këtë proces që në kopsht;
- përmirësimin e shkollave speciale dhe kthimin e tyre në qendra burimore për arsimin e zakonshëm;

Gjithashtu, arsimimi i fëmijëve me AK është përfshirë edhe në strategjinë e MASH-së për edukimin. Pjesë e kësaj strategjie, është edhe *atahimi gradual i psikologëve në shkollat e rregullta, procesi i cili*

sapo ka filluar.

Si përfundim, mund të themi se fillimi i shekullit të 21-të ka sjellë një erë të re dhe mjaft favorizuese për procesin gjithpërfshirës në arsimin shqiptar. Falë përpjekjeve të përbashkëta të organizmave joqeveritarë dhe atyre qeveritarë, mund të deklarojmë me entuziazëm se aktualisht *kemi një variant rajonal të arsimit gjithpërfshirës* i cili mund të shërbejë si model për të zhvilluar praktika edukative gjithpërfshirëse në një shkallë më të gjërë. Gjithashtu, *kemi edhe një kuadër ligjor* të përparuar dhe të krahasueshëm me vendet e zhvilluara *që mbështet këtë risi edukative*. Dhe në të njëjtën kohë, **kemi përpara shumë punë për të bërë që ky kuadër ligjor të bëhet i njohur dhe plotësisht i zbatueshëm**. Unë Jam si Ju –Vëzhgim mbi Situatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Shqipëri” (Closs, Nano, Ikonomi, 2003) si studimi më i plotë i kryer deri tani në fushën e aftësisë së kufizuar, në seksionin mbi arsimimin, konkludon **se shkollimi i të gjithë fëmijëve deri në përfundim të arsimit të detyruar përben një sfidë të madhe për Shqipërinë**, kryesisht për shkak të nivelit ekonomik të familjeve shqiptare, problemeve të transportit dhe mundësive materiale të vogla të shkollave.....”

Pikërisht, temat në vijim të këtij raporti studimr synojnë të trajtojnë çështje që i referohen këtij problemi kaq të rëndësishme dhe imediat.

2. KUADRI LIGJOR EKZISTUES QE GARANTON ARSIMIMIN E FEMIJEVE ME AK NE KUSHTET E ARSIMIT GJITHPERFSHIRES

Pas nënshkrimit zyrtar të Konventës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijës (në shkurt, 1992), shteti shqiptar ka reaguar pozitivisht ndaj të drejtave të fëmijëve me AK dhe është përpjekur hap pas hapi t'i pasqyrojë ato me akte ligjore përkatëse. Në këtë kuadër, mund të përmendim miratimin e ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 të Kushtetutës së RSH për sistetim arsimor parauniversitar, i cili për herë të parë shpalli se:

Neni 3: *Shtetasit e RSH gëzojnë të drejta të barabarta për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimimit ... pavarësisht nga gjendja sociale, shëndetësore, ... dhe niveli ekonomik.*

Neni 39: *Arsimi special publik është pjesë përbërëse e sistemit arsimor publik në RSH. Arsimi special publik synon që nëpërmjet përdorimit të formave dhe metodave të veçanta, të sigurojë zhvillimin sa më të plotë të mundësive të personave të cilët paraqesin paaftësi fizike, mendore ose emocionale, në përputhje me nevojat e tyre dhe kërkesat për një jetë sa më dinjitoze.*

Ky ligj u specifikua në Dispozitën Normative të asaj kohe për shkollat publike, të miratuara nga Minitria e Arsimit, dhe që detyronte organet përgjegjëse ta zbatonin atë. Në adres të fëmijëve me aftësi të kufizuara, DN në fjalë lejonte arsimimin e tyre si në shkollat speciale ashtu edhe në shkollat e zakonshme. Shprehimisht në të thuhej:

Neni 62/1: *Shkollat e arsimit special për nxënësit me paaftësi të ndryshme janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitare publike në RSH;*

Neni 62/8: *Në fshatra ose qytete ku nuk ka shkolla të arsimit special, fëmijët me paaftësi të ndryshme mund të arsimohen në shkollat 8-vjeçare publike, 1-2 xënës për klasë;*

Fatkeqësisht, kjo dispozitë ligjore nuk u shoqërua me dekrete të veçanta për aplikime konkrete, duke lënë kështu shteg për interpretime të ndryshme veçanërisht në aspektin praktik të edukimit. Në këtë mënyrë, ligji as i ndalon fëmijët me aftësi të kufizuara të frekuentojnë shkollat e zakonshme, as nuk garanton edukim të përshtatshëm për ta.

Për shumë vite, ambiguiteti kuptimor i ligjit u ndoq nga konfuzioni i rolit të shkollës dhe sigurisht në një rast të tillë, konsequencat bien mbi nxënësit, veçanërisht atyre me nevoja të veçanta, prezenca e të cilëve në klasat e rregullta shpesh shmanget, refuzohet ose shikohet si barrë nga mësuesit dhe jo si përgjegjësi edukative për të përmbushur nevojat e tyre për rritje dhe zhvillim.

Por, me aprovimin e Dispozitës Normative të dhjetorit 2002, situata ligjore ndryshon duke mbështetur pa ekuivoke të drejtën e fëmijëve me AK për t'u arsimuar në mënyrë të përshtatshme. Kjo DN nuk përjashton asnjë kategori fëmijësh nga arsimi i detyruar, pavarësisht nga aftësitë që ata kanë. Në të njëjtën kohë, ajo garanton tre forma të realizimit të edukimit të tyre, si: shkollat e zakonshme, shkollat e veçanta dhe institucione të tjera (p.sh., shtëpi), për atë grup fëmijësh të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të ndjekin as shkollën e zakonshme as shkollën e veçantë. Lidhur me këtë çështje, neni 57 i kësaj DN, kreu XIII – "Arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta", shprehet si më poshtë:

- [1/b] Për fëmijët me aftësi të kufizuara, të natyrës mendore, fizike, shqisore dhe organike, *shteti përkujdeset dhe krijon mundësi dhe struktura mbështetëse apo organizma të tjerë të larmishëm brenda dhe jashtë shkolle, për zhvillimin në maksimum të potencialeve të tyre.*
- [2] Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara realizohet në *dy forma*: nëpërmjet *integrit* të tyre në shkollat e arsimit publik (*shkollat e zakonshme*) në kuadrin e arsimit *gjithpërfshirës* dhe trajtimit të tyre në shkolla apo *klasa të veçanta (speciale)*, sipas kategorive e specifikave që ata paraqesin, të cilat janë pjesë e rrjetit të institucioneve shkollore parauniversitare publike e RSH.
- [7] *Fëmijët me aftësi të kufizuara mendore apo fizike të rënda*, në pamundësi të trejtohen në shkolla të veçanta, *mund të trajtohen në institucione të tjera* sipas rastit.
- [16] Personeli mësimor-edukativ bën përpjekje që nxënësi me aftësi të kufizuara të mos largohet nga shkolla. Në rast se ai largohet, sipas parashikimit ... *arsimimi i tij mund të vijojë në shtëpi*, nëse prindi e dëshiron një gjë të tillë.

Dispozita Normative e Arsimit Parauniversitar (dhjetor, 2002) garanton jo vetëm të drejtën e fëmijëve me AK për t'u arsimuar në tre forma, por *konkretizon edhe të drejtën e përkatësisë së tyre në shkollat e zakonshme*. Lidhur me këtë, neni 57 i dispozitës normative shprehet:

- [10] *Nxënësit me aftësi të kufizuara*, vërtetuar si të tillë nga organet shëndetësore, *kanë të drejtë të arsimohen në shkollat publike të zakonshme 1-2 nxënës për klasë*. Për këta nxënës *shkolla merr masa dhe bën përpjekje të gjithanëshme për arsimimin, edukimin dhe integrimin e tyre në jetën e klasës dhe të shkollës*.
- [13] Për t'u ardhur në ndihmë dhe *për të lehtësuar punën e mësuesve* që japin mësim në klasat e rregullta ku ka nxënës me aftësi të kufizuar (1-2 nxënës për klasë), mësuesit mund të përfitojnë një nga *alternativat e mëposhtme*:
- Për çdo nxënës me aftësi të kufizuar *ulet me 3 (tre) numri i nxënësve të klasës*;
 - Mësuesit i *ulet ngarkesa javore me 2 (dy) orë mësimore*;
 - Për çdo 4 (katër) orë mësimi të zhvilluara mësuesi *paguhet 1 (një) orë suplementare*.

Në funksion të procesit të integrit dhe të gjithpërfshirjes, neni 57 i DN, tani *parashikon edhe një sërë detyrimesh të tjera ligjore në adresë të shkollës së zakonshme*, që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të planit mësimor, programeve lëndore, teksteve, vlerësimin e fëmijëve me AK, kalimin e tyre nga një klasë në tjetrën, etj. Këto detyrime janë shprehur si më poshtë:

- [17] a) ... nxënësit me aftësi të kufizuara *marrin njohuri në bazë të programeve të thjeshtuara të arsimit 8-vjeçar, të përshtatura sipas mundësive dhe aftësive të tyre*. Përveç njohurive, me një program të zgjeruar të mësimin të punës nxënësve me AK *u jepen njohuri fillestare praktike në profesione të thjeshta*.
- b) Në zbatimin e teksteve dhe programeve mësimore, mbahen parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve. Sipas vështirësive që paraqesin nxënësit, *zbatimi i tyre bëhet në mënyrë krijuese*.
- c) *Për nxënës të veçantë*, gjendja e të cilëve është nën nivelin minimal të programit mësimor ose kur ai paraqet nevoja krejtësisht të veçanta, *do të punohet me plane edukative individuale*.

- [18] *Integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara me nxënësit e shkollave të zakonshme është një proces i domosdoshëm bashkëkohor, që zbatohet në praktikën e shkollave të veçanta dhe që vlerësohet si një proces i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve. Ky proces është i ndërsjelltë dhe për raste të veçanta mund të kalohet në integrim të plotë.*
- [19] *Drejtoritë e shkollave të veçanta krijojnë mundësi që për disa lëndë mësimore, nxënësit me aftësi të kufizuara të zhvillojnë mësim së bashku me nxënësit e shkollave 8-vjeçare të zakonshme, duke vendosur lidhje bashkëpunimi me ato. ... Përveç mësimin, organizohen edhe aktivitetet edukative e argëtuese të përbashkëta.*
- [20] *Vlerësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara bëhet me nota ose me shprehje sintetizuese, njësoj si për gjithë nxënësit e tjerë, por ata kalojnë nga klasa në klasën pasardhëse pa mbetje.*
- [21] *Në përfundim të klasës së tetë, nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, në provimet e lirim të vlerësohen në bazë të programit të veçantë që është aplikuar me ta. Tezat e provimit të lirim, për këtë kategori nxënësish, hartohen nga vetë shkolla, me miratimin e Drejtorisë Arsimore.*

Megjithëse me vonesë, Dispozita Normative e vitit 2002, shënon një arritje të rëndësishme në procesin e përmirësimit të kuadrit ligjor mbi të drejtën e fëmijëve me AK për t'u arsimuar sikurse moshatarët e tjerë normalë. Miratimi i saj, i ***hapi rrugën arsimit gjithpërfshirës në Shqipëri***. Në këtë dispozitë gjen shprehje, për herë të parë dhe në mënyrë të qartë, *tendenca bashkëkohore e integrimit të fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme*, kundrejt veçimit të tyre në institucione speciale, dhe *shpallet si i domosdoshëm arsimit gjithpërfshirës*. Në planin deklarativ, *kuadri ligjor që përfaqëson DN në fuqi vlerësohet si mjaft i përparuar, demokratik dhe i krahasueshëm me standardet e vendeve të zhvilluara.*

Por, - A e përmbush kriterin e përshtatshmërisë në planin praktik ky kuadër ligjor? Sa efektiv është zbatimi i tij në terrenin shqiptar të edukimit?

Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, do t'i referohemi përvojës rajonale të zbatimit të projektit "Arsimi Special i Integruar" (2000-2003) i cili bazuar në kuadrin ligjor ekzistues të arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta të RSH, arriti të modelojë variantin e parë shqiptar të arsimit gjithpërfshirës.

3. PROJEKTI “ARSIMI SPECIAL I INTEGRUAR” – “LABORATORI” QE VURI NE PROVE EFEKTIVITETIN E KUADRIT LIGJOR EKZISTUES PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRE

Projekti “Arsimi Special i Integruar”, zbatuar nga MEDPAK dhe mbështetur nga UNICES, CAD në bashkëpunim me MASH, etj. zhvilloi veprimtarinë e tij në rajonet Librazhd, Elbasan dhe Peqin. Kjo veprimtari u shtri në tre faza (2000-2001;2001-2002;2002-2003”) që realisht i bashkonte i njëjti qëllim – *sigurimi i barazisë arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta*. Si formën më të përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi, projekti zgjodhi arsimin gjithpërfshirës dhe si bazë juridike për të inicjuar këtë formë të re edukative, ai shfrytëzoi ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995 të Kushtetues së RSH, specifikuar në nenin 62/8 të Dispozitës Normative të kohës, i cili shprehet: *“Në fshatra ose qytete ku nuk ka shkolla të arsimit special, fëmijët me paaftësi të ndryshme mund të arsimohen në shkollat 8-vjeçare publike, 1-2 nxënës për klasë”*.

Gjatë aplikimit të këtij ligji në praktikë, projekti u ndesh me vështirësi të cilat konsistonin në:

- Mungesën e njohjes së ligjit për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta nga mësuesit dhe prindërit;
- Hezitimin e mësuesve për të pranuar fëmijët me nevoja të veçanta në klasat e zakonshme pranë vendbanimeve të tyre;
- Atmosferën jo mikpritëse dhe stigmatizuese të moshatarëve të tjerë normalë ndaj nxënësve me AK të përfshirë në klasat e zakonshme;
- Paaftësinë profesionale të mësuesve për të identifikuar dhe trajtuar nga ana edukative nxënësit me AK të përfshirë në klasat e tyre;
- Mungesën e strukturave mbështetëse që lehtësojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në veprimtaritë zhvilluese dhe edukative brenda dhe jashtë shkollës;
- Konfuzionin në procesin e regjistrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme;
- Papërshtatshmërinë e programeve mësimore për t’ju përgjigjur nevojave specifike të nxënësve;
- Paqartësinë e mësuesve për të vlerësuar përparimin e nxënësve me nevoja të veçanta;
- Mungesën e konfortit fizik të shkollës për të pritur fëmijët me nevoja të veçanta;
- Mungesën e mjeteve dhe teknologjive ndihmëse për mësimdhënien efektive në një klasë gjithpërfshirëse;
- Mungesën e masave për të siguruar motivimin e mësuesve që punojnë edhe me fëmijët me nevoja të veçanta;

Për të përmbushur deri në fund misionin e tij, projekti bashkëpunoi me forca të tjera aktive qeveritare dhe joqeveritare, të cilat ishin të interesuara për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës për barazi arsimore të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ky bashkëpunim u konkretizua me aprovimin e Dipozitës Normative për Arsimin Parauniversitar, të dhjetorit 2002, e cila jo vetëm garanton barazi arsimore për të gjithë por parashikon një sërë detyrimesh ligjore drejtuar shkollës së zakonshme për të mbështetur me të gjitha mjetet arsimin gjithpërfshirës (*shih çështjen 2 të këtij raporti*).

Përmirësimi i kuadrit ligjor i dha një shtysë të re veprimtarisë së projektit “Arsimi Special i Integruar” duke mundësuar në këtë mënyrë *gjenerimin e përvojës së parë rajonale të arsimit gjithpërfshirës për Shqipërinë*.

Përfituesit e drejtpërdrejtë të kësaj përvoje, qenë fëmijët me AK dhe vështirësi në të nxënë (160 fëmijë nga rrethi i Librazhdit, 110 fëmijë nga rrethi i Elbasanit dhe 30 fëmijë nga Peqini), nga të cilët 165 u përfshinë në shkollën e zakonshme, ndërsa 35 të tjerëve ju ofrua edukim në shtëpi. Përveç fëmijëve me nevoja të veçanta, në këtë kuadër, përfituan trajnim për arsimin gjithpërfshirës 150 mësues, 30 inspektorë të Drejtorisë Arsimore të atëhershme, 30 punonjës social dhe 300 familje.

Por, në një raport studimor të ndërmarrë nga UNICEF dhe MASH për të vlerësuar arritjet e projektit “Arsimi Special i Integruar” (dhjetor 2003) rezulton se *përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i modelit gjithpërfshirës janë më të gjëra dhe të shumfishta*. Në këtë kontekst, përmendet se:

- *Kuadri ligjor për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta pësoi ndryshime pozitive* përgjatë zbatimit të modelit gjithpërfshirës. Ai u përmirësua ndjeshëm dhe u pasurua me nene të reja, duke shërbyer në të njëjtën kohë, si *bazë juridike për funksionimin e modelit rajonal të gjithpërfshirjes* dhe si garanci për futjen e tij në sistem.
- *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta, përmirësoi dukshëm mundësitë e tyre për të nxënë dhe aftsitë për t’u shoqëruar, ngriti optimizmin e tyre për jetën, forcoi ndjenjën e besimit dhe të qenit i dobishëm në jetë e me dinjitet.*
- *Përdorimi i praktikave gjithpërfshirëse në përvojën e edukimit të zakonshëm u shoqërua me një rritje të njohurive dhe aftësive profesionale të mësuesve të përfshirë në projekt, si dhe me vetëdijen e tyre për t’i pranuar fëmijët AK në klasën e rregullt. Ata u njohën me ligjin, me aftësitë e kufizuara dhe trajtimin e tyre, me teknikat e identifikimit të nevojave specifike të nxënësve, përgatitjen e PEI, punën me prindërit dhe komunitetin.*
- *Shkollat e rregullta që praktikuan gjithpërfshirjen edukative, fituan cilësi të reja duke u bërë më të hapura, më të gatshme për të dhënë ndihmën e tyre dhe për të bashkëpunuar me komunitetin. Ato kuptuan se u përkasin të gjithë fëmijëve, me dhe pa AK, dhe se duhet të punojnë me ndjenjë të lartë përkujdesjeje e përkushtimi për t’i përfshirë të gjithë ata në programet e tyre edukative.*
- *Modeli rajonal i gjithpërfshirjes solli një frymë të re në partneritetin e shkollës me familjen. Ai i ndihmoi prindërit që të zhvillohen si njerëz, duke u bërë më të përgjegjshëm për problemet reale të fëmijëve të tyre dhe i mbështeti ata si individë për të siguruar kompetencat e nevojshme të prindërimit.*
- *Praktika edukative gjithpërfshirëse shkundi plogështinë institucionale dhe zgjoi gatishmërinë për zbatimin e ligjit për arsimimin e fëmijëve me AK dhe në krijimin e kushteve të tjera lehtësuese.*
- *Nga analiza e shpenzimeve, rezulton se modeli arsimor gjithpërfshirës i kushton shoqërisë shumë herë më pak se arsimi special. Kostoja e një edukimi të tillë rezulton 16.2 herë më pak se kostoja e edukimit të fëmijëve me AK në klasat speciale.*
- *Strategjitë e shfrytëzuara për sigurimin e modelit gjithpërfshirës dhe përvoja edukative e fituar në këtë drejtim në shkollat e zakonshme rajonale, përbëjnë një set metodologjik tashmë të sprovuar, përdorimi i të cilit në të ardhmen garanton sukses.*

Arritjet arsimore, sociale dhe ekonomike të modelit gjithpërfshirës janë produkt i suksesshëm i një përvoje të zellshme bashkërenduese, plot përkushtim dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie për ta bërë ligjin për arsimin gjithpërfshirës një realitet konkret. Sipas drejtuesve të shoqatës MEDPAK çelsi i kësaj përvoje të suksesshme, qëndron te:

- *Ndërgjegjësimi i prindërve për misionin e tyre;*

- Trajnimi i drejtuesve të degëve të shoqatës;
- Krijimi i grupit të miqve të shoqatës;
- Prioriteti në zbatimin e përvojës së përparuar gjithpërfshirëse;
- Përqasja e modelit të ri me përvojën tonë të edukimit në shkollën e zakonshme dhe atë speciale;
- Këmbëngulja në zbatimin e ligjshmërisë ekzistuese në fushën e arsimit dhe më gjërë;
- Evidentimi dhe vlerësimi i gjithë fëmijëve me AK duke plotësuar formularët e posaçëm jo nga zyra por duke shkuar shtëpi më shtëpi, duke biseduar me çdo prind që ka fëmijë me AK, duke shqyrtuar gjendjen e çdo fëmije me AK edhe në skajin më të largët;
- Mbajtja e statistikave të rregullta duke bashkëpunuar ngushtë me Zyrat e Ndhmës Ekonomike në komuna dhe bashki;
- Nxitja e gjithë aktorëve përgjegjës për edukimin e fëmijëve që të njohin dhe zbatojnë me korrektësi ligjin për arsimin;
- Trajnimi i edukatorëve, mësuesve, drejtuesve të shkollave të zakonshme, inspektorëve të arsimit dhe inspektorëve të zyrave të ndihmës ekonomike, si dhe mjekve të shërbimit parësor;
- Krijimi i lehtësirave për edukimin e gjithë fëmijëve me AK në klasa integruar me moshatarët, në klasa të veçanta, në Qendrën Ditore dhe në edukimin në familje për t'i dhënë kësaj të fundit, ndihmesën e nevojshme për të riaftësuar fëmijën me AK për jetën;
- Bashkëpunimi me Zyrën e Arsimit dhe me DRA për plotësimin e nevojave të fëmijëve me AK në procesin e regjistrimit të tyre, integritimit, arsimimit, edukimit të përshtatshëm, krijimit të një mjedisi mikpritës në klasat e zakonshme, respektimit si njerëz, vlerësimit të arritjeve, etj. për t'i thënë JO veçimit të tyre në çdo hap të jetës në shkollë;
- Bashkëpunimi me autoritetet e qeverisjes vendore për realizimin e të drejtave të fëmijëve me AK, sidomos të drejtën për përkatësi në shkollat e zakonshme;
- Krijimi i lidhjeve të reja dhe mbajtja e kontakteve me të gjithë miqtë, vullnetarët dhe donatorët e shoqatës;
- Lobim dhe advokaci për problemet që delnin në zbatimin e të drejtave të fëmijëve me AK në vazhdimësi;
- Zbatimi me konsekuencë i Dispozitave Normative nga të gjithë dhe për të gjithë, si dhe përpjekja për ta përmirësuar më tej atë me qëllim që t'i hapet rruga aplikimit të arsimit gjithpërfshirës në të gjithë vendin;
- Eliminimi i barrierave në tekstet dhe programet e shkollës së zakonshme duke arritur që të mësojnë të gjithë fëmijët;
- Eliminimi i barrierave fizike dhe mentaliteve me qëllim që të gjithë fëmijët me AK të përfshihen në klasat e zakonshme pranë vendbanimeve të tyre;
- Edukimi i komunitetit për më shumë tolerancë në përfshirjen e fëmijëve me AK fillimisht në shkollë së bashku me të tjerët, dhe më vonë edhe në sfera të tjera të jetës;
- Sensibilizimi i mbarë shoqërisë shqiptare për të njohur, pranuar dhe respektuar të drejtat e fëmijëve me AK, duke kontribuar në këtë mënyrë në përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të vetvetes.

4. SITUATA AKTUALE E ZBATIMIT TE LIGJIT PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRES NE RAJONET LIBRAZHD DHE ELBASAN

U bënë gati dy vjet që projekti “Arsimi Special i Integruar” ka përfunduar veprimtarinë e tij në rajonet Librazhd, Elbasan dhe Peqin. Natyrisht, ai la pas një përvojë të suksesshme të arsimit gjithpërfshirës dhe një kuadër ligjor në përgjithësi të kompletuar dhe që siguron vazhdimësinë e kësaj përvoje. Por, **si paraqitet situata gjithpërfshirëse aktualisht? Në ç`masë po vepron ligji për arsimin gjithpërfshirës?**

Për të mësuar më shumë rreth këtyre çështjeve, në muajt dhjetor 2004–shkurt 2005, u ndërmorë një studim në rajonet Librazhd dhe Elbasan. Në fillim, objekt i studimit u bënë 7 shkolla të zakonshme 9–vjeçare nga rajonet Librazhd dhe Elbasan. Më pas studimi u zgjerua edhe në institucione të tjera që drejtojnë dhe mbështesin veprimtarinë gjithpërfshirëse të këtyre shkollave si: Zyra Arsimore dhe Zyra e Shërbimeve Sociale, në Librazhd, Elbasan dhe Tiranë, MASH–(Drejtoria e Zhvillimit të Kurrikulave, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Informacionit dhe e Statistikave) dhe Universiteti Elbasanit që përgatit mësues të rinj.

Pavarësisht nga fakti se roli i çdo hallke konsiston në një zinxhir punësh të bashkërenduara mirë, **studimi e pa të dobishme t’i trajtonte ato veçmas dhe rezultatet t’i paraqesë të grupuara në nënçështje të veçanta.** Kjo mënyrë e paraqitjes lehtëson identifikimin e problemeve dhe nevojave specifike të çdo hallke në lidhje me zbatimin e ligjit për arsimimin e fëmijëve me AK në kuadër të edukimit gjithpërfshirës.

4.1. ECURIA E PROCESIT GJITHPERFSHIRES NE SHKOLLEN E ZAKONSHME

Për të përshkruar ecurinë e procesit gjithpërfshirës në shkollën e zakonshme, u gjykua e mjaftueshme që të merren në studim 7 shkolla 9-vjeçare, përkatësisht 3 në rajonin e Librazhdit dhe 4 në qytetin e Elbasanit. Nga këto 7 shkolla, 3 prej tyre nuk ishin përfshirë më parë në projekt. Një kriter i tillë i zgjedhjes së shkollave krijon mundësi më të gjëra për të vjelë dhe krahasuar informacionin rreth *vazhdimësisë së procesit gjithpërfshirës, si dhe për të evidentuar problemet që has ky proces tani që në lojë janë institucionet shtetërore.* Subjekt i studimit në këto shkolla u bënë nxënësit me AK, prindërit dhe mësuesit e tyre, psikologu dhe drejtuesit e shkollës, si dhe bashkëmoshatarët e tjerë normalë. Metodrat e përdorura në studim për grumbullimin e informacionit janë të larshime. Ato përputhen me qëllimet specike të studimit dhe moshën përkatëse të subjekteve. Me fëmijët me AK u përdor më dëndur vëzhgimi në mjediset mësimore dhe në oborr të shkollës, bashkëbisedimi në grup, përfshirja në detyra akademike dhe vizatimore, dhe më rrallë, u përdorën intervistat e drejtpërdrejta. Me bashkëmoshatarët e tyre normalë u përdorën metoda e vëzhgimit, përfshirjes në detyra vizatimi dhe pyetësorët. Me mësuesit, prindërit, psikologun dhe drejtuesit e shkollës u përdorën anketimet, intervistat e drejtpërdrejta dhe ato në telefon.

Numri i **nxënësve me AK** të përfshirë në studim, gjithsej është 25. Ata janë fëmijë nga mosha 9-18 vjeç (me prapambetje mendore të lehtë dhe të moderuar, tetraplegji, epilepsi me kriza të shpeshta, autistë, etj). Nga 25 nxënësit me AK, 60 % e tyre vijnë në shkollë pa ndihmë, ndërsa 40 % vijnë me ndihmën e prindërve, të afërmve ose me një shok. 19 nxënës janë të përfshirë në shkollat e rregullta të rajonit të Librazhdit dhe 6 të tjerët në shkollat në Elbasan. Nga numri gjithsej i nxënësve me AK, 16 prej tyre ndjekin mësimin në klasat e ciklit të ulët, ndërsa 9 nxënës, ndjekin mësimin në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare. Nga nxënësit me AK që ndjekin ciklin e ulët, 4 prej tyre mësojnë në shkolla të papërfshira më parë në projekt, dhe nga nxënësit që ndjekin ciklin e lartë, 3 prej tyre mësojnë në shkolla të papërfshira më parë në projekt.

Nga *vëzhgimi i nxënësve me AK brenda dhe jashtë klasës*, në shkolla të përfshira më parë në projekt dhe atyre të papërfshira, (ose ndryshe, në shkolla me përvojë gjithpërfshirëse në edukim dhe tyre pa përvojë në këtë drejtim), u vu re se kishte *ndryshime të dukshme në raport me reagimet sociale dhe zellin e tyre për t’u angazhuar në detyra akademike individuale ose në grup.* Këto ndryshime janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

<i>Nx. me AK në shkolla/klasa me përvojë gjithëpërfshirëse</i>	<i>Nx. me AK në shkolla/klasa pa përvojë gjithëpërfshirëse</i>
<ul style="list-style-type: none"> • komunikojnë me shokët dhe mësuesen kur është e nevojshme; • janë ulur kryesisht në bankën e dytë ose të tretë nga rreshti i murit; • angazhohen në detyrat që u ngarkon mësuesja; • japin përgjigje kur u kërkohet; • luajnë me shokët në pushimin e gjatë dhe të shkurtër; • kërkojnë ndihmë; • vlerësojnë veten; • recitojnë vjersha të shkurtra; • marrin pjesë në dramatizime me role sekondare; • kur mësuesja drejton pyetje nga mësimi, ata ngrenë dorën si gjithë të tjerët ose tregohen të vëmendshëm se kush do të përgjigjet nga të tjerët; • etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • qëndrojnë të heshtur; • janë ulur në bankën e fundit; • zakonisht vizatojnë ose zhgaravisin; • veprojnë kur ju kërkohet diçka ose ulnin kokën në bankë dhe rrallë herë kthejnë përgjigje verbalisht; • me shokët e klasës komunikojnë rrallë ose aspak; • në rastet kur komunikojnë, bëhen agresivë ose kthejnë kurrizin, ose struken nën bankë si për t' u mbrojtur; • mësuesja merret me ta vetëm orën e fundit të mësimit; • në pushimin e gjatë shpesh lihen në klasë dhe ata ose pastrojnë dërrasën e zezë, ose shohin nga dritrja, ose qëndrojnë në bankën e tyre; • kur dalin në oborr të shkollës, rrallë herë luajnë me shokët ose shoqet, • kur mësuesja drejton pyetje nga mësimi, ata kapnin shokun e bankës, ose kapnin një mjet në bankë si librin, fletoren, etj.; • etj.

Duke krahasuar të dhënat që ofron tabela e mësipërme, dalim në konkluzionin se *nxënësit me AK* që mësojnë në klasat me përvojë gjithëpërfshirëse të fituar në kuadër projektiv, *e ndiejnë veten të përfshirë në të*, ndërsa *nxënësit me AK që mësojnë në klasat papërvojë gjithëpërfshirëse, ndihen të veçuar*. Ata thjesht, janë integruar në klasën e zakonshme, por ende nuk janë përfshirë në të.

Nga bashkëbisedimi në grup dhe nga intervistat e drejtpërdrejta me nxënësit me AK të të dyjka kategorive të shkollave në studim (me dhe pa përvojë gjithëpërfshirëse) rezultoi se:

<i>Pyetjet</i>	<i>Nx. me AK në shkolla me përvojë gjithëpërfshirëse</i>	<i>Nx. me AK në shkolla pa përvojë gjithëpërfshirëse</i>
1. Ku u pëlqen të rrini më shumë, në shtëpi apo në shkollë?	1. 80% e fëmijëve me AK, u përgjigjen “këtu”, pra në klase; 16% në shtëpi; 4% heshtën;	1. Të gjithë fëmijët me AK u përgjigjen “në shtëpi”;
2. A keni shokë në shkollë?	2. 82% e tyre thanë emra ose treguan me gisht nxënës të tjerë nga klasa; 13% thanë PO, por nuk cilësuan nxënës të caktuar dhe 5% nuk dhanë përgjigje;	2. 60% e tyre treguan vetëm shokun e bankës; 15% thanë se e kishin te shtëpia, në lagje ose komshium; 25% heshtën dhe 10% thanë se nuk e dinë;

“Unë dua të rri në klasën e madhe, jo në shtëpi”

(përgjigje e një nxënësi me AK që mëson në një nga klasat me përvojë gjithpërfshirëse, në rajonet e marra në studim. Me “klasë të madhe” nënkupton klasën e zakonshme ku ai mëson).

“ ... Mësuesja më do ... më përqafton ... por unë dua të rri në shtëpi” .

(përgjigje e një nxënëseje me AK që mëson në një nga klasat papërvojë gjithpërfshirëse, në rajonet e marra në studim).

Duke shqyrtuar të dhënat e tabelës dhe përgjigjet e fëmijëve në ilustrimet përkatëse, dalim në përfundimin se *nxënësit me AK në shkollat me përvojë gjithpërfshirëse kanë zhvilluar aftësi për t’u shoqëruar me moshatarët e tyre normalë*. Gjithashtu, pjesa më e madhe e tyre ndihen të sigurt në klasë. Ndërsa *nxënësit me AK në shkollat pa përvojë gjithpërfshirëse, nuk ndihen plotësisht të sigurt në klasën e zakonshme*. Kjo duket qartë kur të gjithë fëmijët me AK shprehen se dëshirojnë të rrinë në shtëpinë e tyre dhe jo në shkollë. Gjithashtu, fakti që shumica e fëmijëve me AK njohin si shok vetëm shokun e bankës dhe jo fëmijët e tjerë e të klasës, lë të kuptohet se mësueset mund të kenë vendosur një kujdestar brenda klasës për të ndihmuar fëmijën me AK dhe përgjithësisht, ky kujdestar i cili është i urtë, zemërgjerë, tepër social, *në vend që ta integrojë fëmijën me të tjerët e veçon atë ose e kufizon vetëm tek vetja*.

Në fakt, përfshirja e fëmijëve me AK në klasat e rregullta varet shumë edhe nga **gatishmëria e fëmijëve të tjerë të klasës** për t’i pranuar dhe vlerësuar ata si shokë. Në këtë kuadër, studimi u shtri më tej se vetë fëmijët me AK, duke synuar të mësojë se *sa të informuar janë nxënësit e klasave të rregullta për aftësitë e kufizuara dhe se si sillen ata që kanë në klasat e tyre shokë me AK*. Për këtë qëllim u zhvilluan vëzhgime dhe detyra vizatimore në katër klasa të ciklit të ulët të të dyja kategorive të shkollave në studim. Gjithashtu u vëzhguan 2 klasa të ciklit të lartë dhe ju shpërndanë pyetësorë 70 nxënësve të klasave të V,VI,VII dhe VIII të shkollës së zakonshme, të cilët aktualisht kanë në klasat e tyre bashkëmoshatarë me AK.

Nga vëzhgimi në mjediset brenda dhe jashtë klasës të nivelit të ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare, u vu re se nxënësit e të dyja kategorive të shkollave *reagojnë me ndjeshmëri ndaj bashkëmoshatarëve të tyre me AK*. Ata i ndihmojnë fizikisht kur është nevoja dhe tregohen të gatshëm për të mësuar bashkë në klasë ose në shtëpi. Përsa i përket pjesmarrjes në lojra të përbashkëta, u vu re se fëmijët me AK, në përgjithësi pranohen në lojë nga bashkëmoshatarët e tyre dhe madje inkurajohen që të luajnë mirë për të mundur kundërshtarët. Në rastet kur loja është e ngarkuar me shumë rregulla, atëherë nxënësit me AK lejohen të qëndrojnë si vëzhgues të lojës në grup.


Kur disave prej nxënësve në studim, ju kërkua të shprehnin në vizatim atë që ndjenin për moshatarët e tyre me AK, shumica e tyre vizatuan një portret që personifikonte një nxënësi të zakonshëm të ulur në bankë, në karrige me rrota ose që qëndronte në këmbë dhe buzëqeshte (por jo të deformuar). Vizatimet u shoqëruan me shprehje inkurajuese sikurse “E. ti je bota!” dhe u zbukuruan me ngjyra të forta dhe zemra.

Për kolin
Djalit më të
mirë të gjithë
Librazhdit.
Vazhdo këshur
Të kam shumë.

XHAN

Milena

3.12.2004



Duke analizuar të dhënat e vjela nga vëzhgimi dhe detyrat vizatimore, rezulton se nxënësit e ciklit të ulët të shkollës 9-vjeçare i pranojnë shokët e tyre me AK. Madje ata duket se janë më pak të vetëdijshëm për dallimet mes tyre. Kjo gjë duket qartë, kur i nxisin fëmijët me AK që të luajnë mirë (njëlloj sikurse bëjnë edhe me moshatarët e tjerë normalë), si dhe në praqitjen e portreteve të tyre pa deformime faciale apo fizike. Mungesa e paragykimeve, e bën më të lehtë mardhënien sociale mes tyre.

Nga vëzhgimi në mjediset brenda dhe jashtë klasës, në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare, u vu re se vajzat tregoheshin më miqësore se sa djemtë në lidhje me nxënësit me AK. Vajzat prireshin të ofronin ndihmë dhe mbështetje edhe kur nuk ishte nevoja, veçanërisht në prezencë të të rriturve, sikurse mësueses së klasës ose prindërve të fëmijëve me AK. Ndërsa djemtë ofronin ndihmë vetëm në rast nevojë, si dhe prireshin të bënin shaka, të cilat shpesh nuk kuptoheshin mirë nga nxënësit me AK dhe këtu fillonte konflikti. Megjithatë, nuk u shfaqën sjellje të dhunshme, por vetëm etiketime dhe ngacmime me fjalë. Përsa i përket pjesmarrjes në lojra të përbashkëta, si vajzat edhe djemtë prireshin t'i pranonin nxënësit me AK në lojë, duke bërë tolerime lidhur me zbatimin e rregullave të lojës. Në rastet kur konkurenca në lojë rritej, dhe bashkë me të interesi për të fituar, atëherë nxënësit me AK përjashtoheshin nga loja e përbashkët dhe lejoheshin vetëm të soditnin. Megjithatë, edhe në këto raste dukej se nxënësit me AK argëtoheshin.

Nga përgjigjet e 70 nxënësve të ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare, për çështje të ndryshme që trajtoheshin në pyetësor, u mësua se:

- për pyetjen se ç'është AK, 65 % e nxënësve besojnë se është pengesë e zhvillimit të disa organeve ose e të gjithë organizmit; 30 % e tyre mendojnë se është sëmundje psiqike; 8 % e lidhin me stresin; 1 % e shikojnë si largimin nga shoqëria dhe 12 % thonë se nuk e dinë;
- përsa i përket të drejtave të fëmijëve me AK, 60 % thonë se janë të njejta me njerëzit e zakonshëm; 40 % mendojnë se janë të ndryshme me ta dhe asnjë prej nxënësve nuk thotë se këto të drejta nuk ekzistojnë;

- lidhur me pyetjen se kë person quani PAK, 5 % quajnë atë që nuk flet; 5 % të tjerë quajnë atë që nuk ka dorë ose këmbë; 10 % një person që nuk shikon dhe nuk dëgjon; 30% atë që nuk ka zhvillim mendor sikurse moshatarët dhe 50 % mendojnë se PAK quhet ai që i ka të gjitha këto gjëra së bashku;
- për pyetjen se a pranoni të qëndroni me një shok me AK, 98% e nxënësve shprehen se PO, 2% e tyre JO; 90 % e nxënësve që pranojnë të qëndrojnë me një shok me AK, thonë se rrinë me ta se i duan pavarësisht nga problemet që kanë, ndërsa 10 % e tyre thonë se qëndrojnë me ta se ju vjen keq, i mëshirojnë; por asnjë nuk thotë se i detyron mësuesja ose ndonjë tjetër;

Nga shqyrtimi i të dhënave të vjela nga pyetësorët dhe vëzhgimi, rezulton se nxënësit e ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare *i njohin AK vetëm nga përvoja në klasë* jo se u është treguar ose mësuar se ç'përfaqësojnë ato realisht. Gjithësesi, kjo njohje përbën një avantazh për ta në raport me ata nxënës të cilët nuk kanë pasur ndonjëherë përvoja të tilla. Kuptimi për të drejtat e fëmijëve me AK, është më i përparuar tek brezi i ri. Ky kuptim del qartë sepse shumica e fëmijëve i konsiderojnë të drejtat e PAK njëlloj si për të gjithë. Por edhe ata që mendojnë se këto të drejta nuk janë të barabarta me të tjerët (pra, ndryshojnë), përsëri pranojnë faktin se PAK kanë të drejta. Lidhur me *qëndrimet sociale të nxënësve të ciklit të lartë ndaj nxënësve me AK*, duket qartë se ato *reflektojnë dallime gjinore*. Pranimi në lojra të përbashkëta fillon dhe kushtëzohet nga aftësitë e kufizuara dhe mardhëniet shoqërore nuk janë janë aq përkrahëse sa tek nxënësit e fillores. Duket se hendeku shoqëror thellohet me rritjen e fëmijëve. Gjithësesi, këto mardhënie, *në shumicën e rasteve karakterizohen si dashamirëse dhe miqësore*. Rastet e konflikteve, tregojnë se ndoshta ata nuk dinë aq mirë se si të sillen me fëmijët me AK.

Padyshim, **mësuesit** janë ata që përbëjnë hallkën më të rëndësishme në zbatimin e procesit gjithpërfshirës. Nga vetëdija e tyre, niveli i njohurive dhe aftësive mësimdhënëse në kuadër të gjithpërfshirjes, varet suksesi i nxënësve me dhe pa AK, dhe bashkë me të, edhe efektiviteti i zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës. Nisur nga ky këndvështrim, studimi e pa me vend të informohej për *aspekte të veçanta të punës së mësuesve lidhur me nxënësit me AK të përfshirë me klasat e tyre*. Për këtë arsye në studim u morën 30 mësues që kanë nxënës me AK në klasat e tyre. Nga këta, 20 janë përfshirë më parë në projekt dhe 10 të tjerë, nuk janë përfshirë më parë në projekt. Nga 10 mësuesit pa përvojë gjithpërfshirëse, 5 prej tyre janë mësues të ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare. Kjo zgjedhje u bë *për të krahasuar nivelin e zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës në dy kategori të ndryshme mësuesish* (me dhe pa përvojë gjithpërfshirëse) dhe *për të zbuluar se çfarë pengesash ndeshin ata në këtë proces pavarësisht nga cikli ku japin mësim*. Duke mësuar rreth këtyre çështjeve, në të ardhmen mund të parashikohen strategji specifike për mbështetjen dhe kualifikimin e çdo kategorie mësuesish.

Informacioni i nevojshëm për qëllimet e mësipërme, u siguroa përmes metodës së anketimit dhe intervistës së drejtpërdrejtë.

Nga anketimi dhe intervista e 20 mësuesve të përfshirë më parë në projekt, pra me përvojë gjithpërfshirëse, u mësua se:

- 100% e tyre kishin dijeni për kuadrin ligjor mbi arsimin gjithpërfshirës;
- 25 % e mësuesve në studim deklarojnë se kanë përfituar alternativën me pagesë (deri në 170 orë suplementare në vit). 75 % e tyre, deklarojnë se nuk kanë përfituar asnjë nga alternativat që përkrahen DN. Kur pyeten - Pse ndodh kështu? – ato u përgjigjen: Drejtuesit na thonë se nuk ka fond të veçantë të detajuar nga MASH për këtë çështje. Ose, - Zyrat e financës në komuna dhe bashki nuk kanë shumë fonde për të paguar shumën e orëve suplementare. Ose, - DA njeh si orë suplementare vetëm orët që bëjnë mësuesit e tjerë kur mungon kuadri përkatës.

- Të gjitha mësueset deklaruan se vazhdojnë të punojnë individualisht me nxënësit me AK, por kur ju kërkua PEI, vetëm 20% e tyre i paraqitën ato. Të tjerat, që nuk kishin PEI, shpjeguan se mund të bënin edhe pa to, sepse i njohin problemet individuale të fëmijës lidhur me të nxënit dhe i ndjekin çdo ditë ndryshimet e tij!
- Të gjitha mësueset deklaruan se nuk kishin pasur kualifikime të tjera në kuadër të gjithpërfshirjes pas përfundimit të projektit “Arsimi Special i Integruar” dhe u shprehën se në këtë aspekt, e ndjenin nevojën për kualifikime në vazhdimësi sepse fëmijët me AK në klasat e tyre rriten, ndryshojnë dhe me kalimin e kohës shfaqin sjellje të reja, të paparashikuara, jo të zakonit dhe mësueset nuk dinë si të reagojnë;
- Të gjitha mësueset vazhdonin të ruanin lidhje të ngushta me prindërit e fëmijëve me AK, për të siguruar informacion dhe mbështetje;
- Përsa i përket bashkëpunimit me psikologun përgjegjës për shkollën e tyre, 75 % e mësueseve deklaruan se ishin takuar disa herë dhe tema e bisedës kishte të bënte thjesht me rolin e psikologut si këshillues psikologjik me nxënësit në përgjithësi; 20 % treguan se i kishin ftuar në klasën e tyre për të zhvilluar bisedë me nxënësit për vetvrasjen duke theksuar dashurinë për jetën; ndërsa 5 % u shprehën se nuk e njihnin fare se kush ishte psikologu i shkollës;

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme mund të gjykohej se *ligji për shpërblimin e mësuesve që përmbushin kushtet, ende nuk vepron plotësisht*. Aktualisht në rajonin ku vepron projekti, nga 160 mësues të kualifikuar dhe të vetëdijshëm për ekzistencën e tre alternativave motivuese (pagesë ekstra, ulje të numrit të nxënësve apo orëve mësimore) vetëm 25 prej tyre përfitojnë 170 orë suplementare në vit. *Mungesa e motivimit mund të përbëjë një faktor që ul interesin dhe seriozitetin e mësuesve me përvojë gjithpërfshirëse për të punuar me të njejtin ritëm si më parë me fëmijët me AK*. Kësaj situate i shtohet edhe *mungesa e vazhdimësisë në kualifikime*, duke kontribuar në këtë mënyrë në “varfërimin” e përvojës së ftuar në kuadër projekti. Ndërsa *roli i psikologut nuk është shumë i qartë* për mësueset me përvojë gjithpërfshirëse lidhur me mbështetjen psikologjike të nxënësve me AK në shkollën e rregullt.

Nga anketimi dhe intervista e 10 mësueseve të ciklit të ulët dhe të lartë, pa përvojë gjithpërfshirëse, përgjigjet rezultuan si më poshtë:

- 90 % e mësueseve nuk kishte një kuptim të qartë për kuadrin ligjor për arsimin gjithpërfshirës;
- Asnjë prej tyre nuk përfitonte ndonjë nga tre alternativat që ofron ligji: pagese ekstra, më pak nxënës ose më pak orë. Kur u pyetën –Pse ndodh kështu? – mësueset u përgjigjën se nuk u kishte folur askush për këto gjëra, pra nuk kishin dijeni;
- Të gjitha mësueset deklaruan se i kushtojnë vëmendje dhe punojnë individualisht me nxënësin me AK, por asnjë prej tyre nuk kishte dijeni për përgatitjen e PEI dhe teknikat e edukimit gjithpërfshirës. Në këtë pikë 90 % e tyre theksuan përdorimin e metodës së shpjegimit të mësimin në mënyrë më të thjeshtë për nxënësit me AK. 10 % deklaruan se nuk mund të prishnin tërë orën e mësimin vetëm për një nxënës;
- Të gjitha mësueset pranuan nevojën për kualifikime në fushën e edukimit gjithpërfshirës;
- 6 mësues u shprehën se bashkëpunojnë me prindërit e fëmijëve me AK, veçanërisht me nënën e

tyre; 4 mësues treguan se prindërit nuk interesohen shumë se si shkon me mësimet fëmija i tyre. Edhe ata vetë janë të pashkolluar.

- Përsa i përket bashkëpunimit me psikologun e shkollës, 5 mësues shpjeguan se ai nuk është çdo ditë në shkollë, por kur ka ditën e këshillimit, ndonjëherë e takojmë, kryesisht flasim për nxënësit me probleme në sjellje dhe ata që braktisin mësimin. 3 mësuese u shprehën – PO, por nuk komentuan, ndërsa 2 mësuese nuk u prononcuan;

Nga analiza e përgjigjeve të mësuesve të papërfshira më parë në projekt, por që aktualisht kanë në klasën e tyre nxënës me AK, mund të gjykohet se *ka mungesë të njohjes së kuadrit ligjor për arsimin gjithpërfshirës*, gjë që cënon drejtpërsëdrejti efektivitetin e zbatimit të tij. *Nuk kanë marrë kualifikimin e nevojshëm* për t'i paraprirë zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës, për të përdorur teknika edukative të përshtatshme me nxënësit me AK dhe për të punuar me efektivitet me prindërit e fëmijëve me AK. Metoda mbizotëruese në mësimdhënien e tyre është shpjegimi. *Bashkëpunimi me psikologun është i paqartë*, veçanërisht në raport me nxënësit me AK dhe gjithpërfshirjen në arsim.

Përsa i përket vështirësive që ndeshin mësuesit e marrë në studim, gjatë punës mësimore dhe edukative me nxënësit me AK të përfshirë në klasat e tyre të zakonshme, të dyja kategoritë e mësuesve (me dhe pa përvojë gjithpërfshirëse) shpjeguan:

- mungon kualifikimi për mësuesit të cilët kanë në klasat e tyre nxënës me AK;
- mungojnë mjetet dhe materialet e punës, duke filluar nga më të thjeshtat sikurse janë fletët e vizatimit, letrat me ngjyra, lapustilat, hartat, ... materialet që konkretizojnë mësimin në përgjithësi. Gjithçka duhet ta gjej mësuesi! Por, natyrisht ato edhe kushtojnë!. Prindërit e fëmijëve me AK, në përgjithësi nuk mund t'i sigurojnë mjetet dhe materialet për zhvillimin e mësimin të fëmijës së tyre në klasë. Shumica e tyre kanë nevoja ekonomike!
- puna në klasën e zakonshme me një ose dy nxënës me AK nuk mund të përballohet vetëm nga një mësues, është shumë e lodhshme, ndërkohë që programi është shumë i ngjeshur dhe nuk bën diferencime;
- është e vështirë, duhet durim, përkushtim, të zhvishesh nga problemet personale, të sforcohesh për të bërë më të mirën që mundesh si mësues;
- numri i madh i nxënësve në klasë, nuk lë shumë kohë që të merresh me nxënësin me AK, dhe ndonjëherë ndodh që ai “të harrohet” në bankën e fundit;
- nuk ka standarde që të orientojnë mësuesin se në ç’ nivel duhet të përvetësojnë programet lëndore nxënësit me AK në raport me bashkëmoshatarët e tyre normalë, ose programe lëndore që të përputhen me mundësitë e tyre;
- mësuesit e ciklit të ulët shprehin shqetësim për vlerësimin e nxënësit me AK me nota kaluese në fund të klasës së katërt;
- Mësueset e ciklit të lartë shprehin shqetësim se si do të paguhen të gjithë ata mësues që japin mësim në klasën e zakonshme të ciklit të lartë, në të cilën ka një ose dy nxënës me AK.

Duke analizuar përgjigjet e mësuesve lidhur me vështirësitë që ato ndeshin për të zbatuar ligjin për arsimin gjithpërfshirës, mund të thuhet se të gjithë mësuesit ndihen vetëm ose të braktisur në përpjekjet e tyre për të realizuar gjithpërfshirjen. Ende nuk është specifikuar juridikisht mënyra se si do të zbatohet ligji për arsimin gjithpërfshirës me mësuesit e ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare. Programet shkollore nuk janë gati për t'iu përgjigjur zhvillimeve të reja gjithpërfshirëse. Reduktimi ose modifikimi i tyre është lënë në dorë të mësuesit. Kualifikimet që realisht duhet t'i kishin paraprirë futjes së arsimit gjithpërfshirës në sistem, nuk kanë funksionuar drejtë. Të marra të gjitha së bashku, këto probleme bëhen burim stresi dhe konfuzioni për mësuesin dhe ndikojnë në uljen e efektivitetit të zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës. Në veçanti, *shkollat e pa përfshira më parë në projekt, nuk janë të përgatitura për të përfshirë fëmijët me AK në qëllimet e tyre edukative.*

Prindërit e fëmijëve me AK mund të jenë një mbështje e fuqishme e punës së mësuesit si brenda ashtu edhe jashtë klasës, nëse energjitë dhe interesat e tyre kanalizohen në mënyrë të drejtë. Nga kjo pikëpamje, u pa e udhës që në studim të përfshihen edhe prindërit e fëmijëve me AK. Për këtë qëllim, u zhvilluan pyetësorë me 30 prindër të fëmijëve me AK të zonës së Shushicës, Labinotit dhe Gjinarit, ku dhe sfidat e shkollës për të bashkëpunuar me ta, mendohet se janë më të mprehta se sa në zonat urbane.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetësore u mësua se:

- mbi 80% e prindërve është me arsim fillor, rreth 10 % me arsim të mesëm dhe 10 % të paarsimuar;
- megjithatë, të gjithë prindërit mendojnë pozitivisht për fëmijën e tyre me AK. Lidhur me pyetjen se “si mendoni për fëmijën tuaj ...?” disa nga thëniet e tyre janë: Në sytë e mi duket si engjell që Perëndia ma dhuroi; Eshtë si yll, me shpirt e trup do ta mbroj; Eshtë gëzimi i jetës sime, drita e syve të mi; Eshtë si pellumb paqeje; etj.
- 90 % e prindërve thonë se nuk e njohin mirë diagnozën mjekësore të fëmijës së tyre edhe pse në kuadër projekti, u është thënë diçka për këtë gjë. Si rrjedhojë ata nuk mund t'i japin ndihmën e nevojshme fëmijës së tyre;
- në lidhje me të drejtat e fëmijëve me AK, pjesa më e madhe e prindërve tregojnë se nuk i njohin të gjitha të drejtat, por theksojnë që fëmijët e tyre kanë të drejtë të ndihmohen. Si rrjedhojë këta prindër as nuk mund t'i kërkojnë të drejtat që u takojnë fëmijëve të tyre;
- përsa i përket pyetjes se çfarë ndihme duan për fëmijën e tyre, një pjesë e prindërve kërkonë vizita mjekësore, ndonjë kërkon paisje ndihmëse si syze, karrige me rrota, etj, pra, ndihmë teknike dhe ekonomike. Por, asnjë nuk kërkon ndihmë për arsimimin e fëmijës me AK;
- Shumica e prindërve pohojnë se bashkëpunojnë me mësuesit, por asnjë prej tyre nuk është në gjendje të përshkruaj konkretisht kontekstin e këtij bashkëpunimit.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të prindërve me AK të zonës së Shushicës, Labinotit dhe Gjinarit, rezulton se *niveli arsimor i tyre është shumë ulët.* Asnjë prej tyre nuk është me arsim të lartë, ndërkohë që 90% e prindërve nuk kanë mbaruar as arsimin e detyruar sipas legjislacionit shqiptar. Në këto rrethana, *kontributi i tyre për mirërritjen dhe arsimimin e fëmijëve me AK, është minimal.* Ndërsa niveli i bashkëpunimit të tyre me shkollën në mbështetje të arsimit gjithpërfshirës, parashikon vështirësi të mëdha. Gjithsesi, *dashuria e tyre për fëmijën me AK është e pakufishme dhe gatishmëria për ta ndihmuar atë nuk u mungon.*

Drejtuesit e shkollës së zakonshme kanë përgjegjësi për të siguruar dhe monitoruar procesin e gjithpërfshirjes arsimore në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues. Ata mbajnë përgjegjësi direkte për

mosnjohjen dhe zbatimin jo korrekt të DN nga stafi mësimdhënës që ata drejtojnë. Dhe nga ana tjetër, zhvillojnë strategji të ndryshme për të mbështetur dhe lehtësuar veprimtaritë konkrete mësimore dhe edukative të parashikuara nga mësuesit e shkollës në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. Për të mësuar rreth rolit aktual të drejtuesve të shkollës së zakonshme në kuadër të zbatimit të ligjit ekzistues për arsimin gjithpërfshirës, studimi zhvilloi anketime, intervistua të drejtpërsëdrejta dhe në telefon me 15 drejtues shkollash (përfshi edhe nëndrejtorë) të të dyja kategorive të shkollave (me dhe pa përvojë gjithpërfshirëse).

Drejtuesit me përvojë gjithpërfshirëse dëshmuan se:

- kanë një kuptim teorik të qartë për arsimin gjithpërfshirës;
- 60 % e tyre mendojnë se arritjet më të mëdha fëmijët me AK i kanë pranë moshatarëve të tyre në klasat e zakonshme, ndërsa 40 % e tyre mendojnë se këto arritje do t'i kenë në klasat speciale;
- vazhdojnë të ruajnë përvojën e fituar në kuadër projekti lidhur me arsimin gjithpërfshirës, por ka vështirësi për të siguruar gjithpërfshirjen e fëmijëve. Ky proces varet shumë nga familja e fëmijës me AK dhe nga motivimi i mësuesve që punojnë me këta nxënës;
- lidhur me motivimin e mësuesve që punojnë me nxënësit me AK në klasat e zakonshme, 60 % e drejtuesve thonë se duhet të paguhen, 20 % thonë se duhet të zbatohet DN, ndërsa 20 % thonë se nuk e kanë kuptuar pyetjen;
- nuk kanë marrë kualifikim për vazhdimësinë e përvojës gjithpërfshirëse;
- pranojnë se procesi i regjistrimit të fëmijëve me AK nuk po bëhet i studjuar mirë. Përveç mësuesit dhe mjekut duhet të ngrihet një komision më i gjërë në shkollë që të vendosë për shtyrjen ose jo të regjistrimit të fëmijës me AK në shkollë. *[Në DN, neni 8, pika 2 thuhet: Në raste tepër të veçanta për një fëmijë 6-vjeçar që ka zhvillim shumë të dobët, mbështetur në kërkesën me shkrim të prindit dhe bazuar në raportin mjeko-ligjor, me propozim të drejtorit të shkollës, DA mund të marrë vendimin për styrjen e regjistrimit të nxënësit të klasës së parë një vit më vonë. Vendimi depozitohet në në arkivin e DA (sot ZA) ndërsa kopja e tij ruhet në arkivin e shkollës]. Asnjë drejtor shkolle nuk kishte në arkiv një dokument të tillë, ndërkohë që ka mjaft fëmijë normalë që hynë në klasë të parë pasi kanë mbushur 7 vjeç!*
- bashkëpunimi me MEDPAK vazhdon të jetë prezentë dhe përbën të vetmen ndihmë për momentin;
- vlerësojnë futjen e shërbimit psikologjik në shkollat e zakonshme dhe bashkëpunojnë me psikologun përkatës për të fokusuar punën e tij te fëmijët me AK. Por deri tani, puna e psikologut ka konsistuar vetëm në njohjen e problemit;

Drejtuesit e shkollës së zakonshme pa përvojë gjithpërfshirëse dëshmuan se:

- e njohin kuadrin ligjor për arsimin e fëmijëve me AK dhe në bazë të tij kanë vepruar për pranimin e fëmijëve me AK në klasat përkatëse. Gjithashtu, ata kanë orientuar mësueset që të kalojnë nga klasa në klasë pa mbetje nxënësit me AK;
- nuk kanë ndonjë kuptim të qartë për arsimin gjithpërfshirës as teorikisht as praktikisht;

- lidhur me çështjen se sa e njohin mësueset e shkollës kuadrin ligjor për arsimin gjithpërfshirës dhe DN të dhjetorit 2003, përgjigjet ishin – Sigurisht! PO, po! Ma do mendja PO!
- Drejtuesit diskutojnë me mësuesit për përparimin e nxënësit me AK, por ata nuk kanë dijeni për përgatitjen e PEI apo për përdorimin nga ana e mësuesit të teknikave të veçanta të punës me këtë kontingjent nxënësish;
- nuk kanë marrë ndonjëherë kualifikim për AK dhe trajtimin e tyre në klasat e zakonshme;
- pagesa e mësuesit me orë suplementare nuk është në kompetencë të drejtorisë së shkollës, por të ZA;
- përfshirja e specialistit të shërbimit psikologjik është një gjë e mirë por roli i tij në lidhje me nxënësit me AK ende s'ka gjetur konkretizim.

Nga analiza e përgjigjeve të marra nga drejtuesit e të dy kategorive të shkollave rezulton se *drejtuesit e njohin kuadrin ligjor për arsimin gjithpërfshirës dhe përpiqen sipas mënyrës së tyre që ai të funksionoj*. Në këtë kuadër, ata kanë orientuar mësuesit që të pranojnë nxënësit me AK në klasat e tyre, në rast se prindërit e tyre e dëshirojnë një gjë të tillë dhe të respektojnë kalimin pa mbetje në klasë. Lidhur me procesin e regjistrimit të fëmijëve me AK në klasën e parë, drejtuesit shprehen se nuk po realizohet në mënyrë të studiuar mirë. *Ata nuk kanë një kuptim të qartë teorik dhe praktik për arsimin gjithpërfshirës dhe u mungojnë kualifikimet në këtë drejtim*. Gjithashtu, ata nuk mund të zbatojnë ligjin për motivimin e mësuesve sipas tre alternativave të përcaktuara në DN. Për këtë arsye, shpesh drejtuesit e shkollave të papërfshira në projekt nuk i informojnë mësuesit e tyre për të drejtën e motivimit, duke e lënë këtë çështje në heshtje. Drejtuesit e shkollës e vlerësojnë futjen e shërbimit psikologjik në shkollat e zakonshme por sipas tyre, kjo përvojë do kohë të konsolidohet.

Përvoja më e re e shkollës së zakonshme gjithpërfshirëse është futja e **shërbimit psikologjik**. Ky shërbim nisi në fillim të vitit mësimor 2004-2005. Për të mësuar rreth vendit që zenë fëmijët me AK në punën e psikologut të shkollës në kuadër të edukimit gjithpërfshirës, u shqyrtua dokumenti që parashikon rolet e specialistit të shërbimit psikologjik në shkollat e zakonshme, si dhe u zhvilluan intervista të drejtpërdrejta dhe me telefon, me 4 psikologë që mbulojnë edhe nevojat e disa shkollave 9-vjeçare të rajoneve në studim. Nga shqyrtimi i dokumentit përkatës, u mësua se në punën e specialistit të shërbimit psikologjik, midis të tjerash një vend të rëndësishëm ze edhe edukimi special. Në këtë kontekst, detyrat e specialistit të shërbimit psikologjik janë:

- ndihmon në përgatitjen e planit të veprimtarive për fëmijët me nevoja të veçanta;
- bën vlerësimin e ecurisë së fëmijëve me nevoja të veçanta;
- administron vlerësimet e bëra;
- bën rekomandimet e duhura;
- përgatit me shkrim raporte për vlerësimin;
- ndihmon në përgatitjen e programeve mësimore-edukative individuale;
- siguron ndërhyrjen e shërbimeve të specializuara sipas problemeve që kanë fëmijët.

Por, sa të angazhuar e ndiejnë veten specialistët e shërbimit psikologjik në përmbushjen e detyrave të mësipërme? Përgjigjet e marra nga 4 psikologët e intervistuar tregojnë se në këtë drejtim, ka mjaft probleme dhe vështirësi, si:

- psikologët e intervistuar deklarojnë se çdo njeri prej tyre ofron shërbim psikologjik në tre ose katër shkolla të ndryshme, me një numër total nxënësish mbi 3000 vetë;
- të gjithë të intervistuarit kanë mbaruar arsimin e lartë për mësuesi (dega cikli i ulët, mat-fizik, etj dhe asnjë psikologji). Një prej tyre ka mbaruar kurs pasuniversitar për psikologji të mësimdhënies, ndërsa të tjerat, deklaruan se kishin kualifikime afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit në fushën e psikologjisë feminare (por nuk i dokumentuan deklaratat e tyre!);
- të gjithë të intervistuarit shprehën nevojën për kualifikime, veçanërisht në fushën e edukimit special;
- lidhur me identifikimin e fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme ku të intervistuarit shërbejnë, dy prej tyre pranuan se kanë identifikuar nxënës të tillë, por ende nuk kanë përgatitur ndonjë plan pune lidhur me këtë çështje; ndërsa dy të tjerët, të cilët shërbejnë në shkolla ku realisht studimi ka identifikuar 5 nxënës me AK, deklaruan se nuk ka nxënës të tillë në shkollat e tyre!
- të gjithë të intervistuarit deklarojnë se nuk kanë marrë ndonjë orientim konkret nga ZA (inspektori përkatës) lidhur me zbatimin e detyrave të tyre në shkollë. Për këtë arsye, ata shpjegojnë se më shumë veprojnë sipas përvojës së tyre si ish-mësues kujdestar se sa si psikolog i mirfilltë.
- të gjithë të intervistuarit pranojnë se bashkëpunojnë me mësuesit dhe përpiqen t'i ndihmojnë ata me aq sa munden, veçanërisht kur kërkojnë ndihmë;
- shërbimi e tyre deri tani është fokusuar tek këshillimi individual i nxënësve dhe ai në grup, kualifikimi i stafit dhe puna me prindërit e fëmijëve që kryesisht braktisin shkollën.

Nga analiza e përgjigjeve të mësipërme rezulton se specialistët e shërbimit psikologjik *i njohin detyrat e tyre por nuk janë orientuar konkretisht* nga instancat përgjegjëse se si t'i përmbushin ato në mënyrë cilësore. Ata kanë *vështirësi të ofrojnë shërbimet e përcaktuara në udhëzimin përkatës për kontigjentin e nxënësve me AK* sepse kanë mungesë të njohurive rreth AK, mënyrave të identifikimit dhe trajtimit të tyre në shkollën e zakonshme. *Numri i madh i shkollave përbën një problem tjetër që ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimit psikologjik.* Specialistët e shërbimit psikologjik janë në fazën e njohjes së problemeve të shkollës së zakonshme dhe në këtë proces *ndiejnë nevojë për kualifikime teorik dhe praktik.*

4.2 ROLI I ZYRES ARSIMORE NE KUADER TE ZBATIMIT TE LIGJIT PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRE

ZA është institucioni i cili jo vetëm bën të njohur për mësuesit dhe drejtuesit e tyre ligjet dhe dispozitat normative për arsimin parauniversitar, por edhe ndjek nga afër se si po zbatohen këto ligje dhe dispozita. Nga ky këndvështrim ZA mund të jetë vendi nga ku mund të mësohet më shpejt se në ç' *masë po vepron ligji për arsimimin e fëmijëve me AK dhe se çfarë e pengon zbatimin e plotë të tij.*

Orientuar nga këto qëllime, studimi zhvilloi intervista me drejtuesit e ZA në Elbasan, me 2 inspektorë të Zyrës së Kualifikimit dhe 1 punonjës të Zyrës së Statistikave dhe 4 punonjës të Drejtorisë Arsimore Tiranë;

Përmbajtja e intervistës kishte të bënte me njohjen e Dispozitës Normative të Arsimit Parauniversitar (dhjetor 2002), me nivelin e procesit gjithpërfshirjes ndërkohë që projekti "Arsimi Special i Integruar" nuk vepron më, me kualifikimin e mësuesve, statistikën me numrin e fëmijëve me AK dhe problemet specifike të tyre, etj. Përmes këtyre intervistave, u mësua se:

- drejtuesit dhe inspektorët e ZA kanë dijeni për përmbajtjen e nenit 57 të Dispozitës Normative lidhur me mundësitë për arsimimin e fëmijëve me AK;
- Një nga drejtuesit kryesor të ZA, pohon se vitin e kaluar (2003) në kuadër të arsimit inkluziv, një pjesë e stafit të ZA ka marrë disa kualifikime, si nga përfaqësues të MASH ashtu edhe nga shoqatat e ndryshme të cilat kanë vepruar në këtë drejtim në rrethin e Elbasanit;
- lidhur me angazhimin e ZA në zbatimin e nenit 57 të arsimimit të fëmijëve me AK, drejtuesi shprehet se vullneti nuk mungon. Kështu, kohët e fundit, udhëzuar nga MASH, u punua për të emëruar psikologun e shkollës dhe mësuesit të cilët do të punojnë me fëmijët që hasin vështirësi në të nxënë, përfshirë këtu edhe fëmijët me AK. Por, pavarësisht nga vullneti i mirë, ka vështirësi që nuk mund të shmangen lehtë. Lidhur me këtë, përmendet fakti se në rrethin e Elbasanit ka mungesë kuadroshe të diplomuar në psikologji. Nga ana tjetër, shkolla speciale e këtij rrethi është duke u mbyllur për mungesë fondesh, mjetesh dhe materialesh mësimore. Në këto kushte, shumica e prindërve që ndeshin pengesa në regjistrimin e fëmijëve me AK në shkollat e rregullta, detyrohen t'i mbajnë fëmijët në shtëpi duke i privuar nga e drejta për arsim. Edhe ato mësuese të pakta që i pranojnë fëmijët me AK në klasat e zakonshme, mendojnë se pagesa nuk e justifikon lodhjen e tyre (15.000 lekë në vit). Një pjesë e mirë e mësueseve nuk zotërojnë njohuritë dhe teknikat për të punuar me fëmijët me AK, përveç disa mësuesve të cilat kanë qënë të përfshira në projekte speciale.
- inspektorët e Sektorit të Kualifikimit, në ZA tregojnë se kualifikimi për arsimimin e fëmijëve me AK është parashikuar të përqëndrohet te mësueset e CU dhe Parashkollor, jo në nivele të tjera;
- stafi i kualifikimit ndesh vështirësi në përcaktimin e temave kualifikuese dhe në organizimin e kualifikimit sepse nuk mund të ofrojnë specialistë të fushës së edukimit gjithpërfshirës përse kohë ZA nuk ka fonde për kualifikime. Ata theksojnë se roli i tyre nuk është që të kualifikojnë vetë mësuesit, por të identifikojnë nevojat dhe të bashkëpunojnë me institucione të specializuara për të thithur specialistë të ndryshëm dhe për të ofruar shërbime cilësore;
- megjithatë, për të ardhmen është planifikuar krijimi i një grupi pune i cili do të shërbejë për të transmetuar përvojën e punës me fëmijët me AK në shkollat e rregullta dhe janë parashikur disa tema kualifikimi për mësuesit.
- Të intervistuarit deklarojnë se sot për sot mungon infrastruktura që mbështet arsimimin e fëmijëve me AK pranë shkollave të rregullta. S'ka asistencë për mësuesit në raste të tilla;
- ZA nuk disponon asnjë listë për numrin dhe emrat e fëmijëve me AK. Lidhur me këtë problem, punonjësi përkatës pranë ZA shprehet se nuk na është kërkuar ndonjëherë nga MA një gjë e tillë, po të më kërkohet artëherë do ta bëj;
- për identifikimin e fëmijëve me AK, ZA bashkëpunon me Zyrën e Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë së Qytetit, si dhe me shoqata të ndryshme të cilat regjistrojnë për ndihmë fëmijët në nevojë, sepse vetë shkolla nuk ka mundësi të zbulojë të gjithë fëmijët me AK;

Nga analiza e të dhënave të vjela përmes intervistave me drejtues të ZA dhe inspektorët e saj në Zyrën e Kualifikimit dhe Statistikës, rezulton se një pjesë e stafit të ZA në Elbasan ka marrë kualifikim nga përfaqësues të MASH për zbatimin e ligjit për arsimin gjithpërfshirës, por në morinë e problemeve

që ka zbatimi i ligjit në praktikën edukative, *ky kualifikim nuk është i mjaftueshëm*. Nderkohe që në Zyren Arsimore Tirane, pranohet fakti se mungon dhe ndjehet ndjeshëm nevoja për kualifikim në lidhje me problematiken e arsimit gjithë përfshires. *Ekziston vullneti i gjithë stafit për të realizuar gjithpërfshirjen në arsim, por ka vështirësi për të siguruar fonde për kualifikimin cilësor të masës së mësuesve*. Futja e shërbimit *psikologjik në shkollat e zakonshme cilësohet si një hap i rëndësishëm në ndihmë të mësuesit, nxënësve me AK, dhe vështirësi në të nxënë. ZA ka njohje të problemeve të arsimit të fëmijëve me AK, por nuk ka ndonjë statistikë me emrat e nxënësve me AK*. Për rregjistrimin e tyre në shkollë, shpesh *bashkëpunohet me shoqatat joqeveritare*.

4.3 ROLI I ZYRES SE SHËRBIMEVE SOCIALE NE LIDHJE ME ARSIMIN GJITHPËRFSHIRE

Për të rritur kujdesin ndaj qytetarëve të vetë, çdo bashki ka nën juridiksionin e saj një zyrë të veçantë të njohur si Zyra e Shërbimeve Sociale (ZSHS). Me problemet e fëmijëve me AK dhe familjeve të tyre, merret Sektori i Shërbimeve Sociale të kësaj zyre, i cili përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe nga tre specialistë ose inspektorë. Duke menduar rëndësinë e këtij sektori lidhur me jetën e fëmijëve me AK, u mendua që të përfshihen në intervistim të gjithë punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale në Elbasan dhe Librazhd. Përmes kësaj interviste u synua të mësohej rreth *rolit dhe detyrave të sektorit të shërbimeve sociale*, për mënyrën e organizimit të punës në këtë zyrë, për llojet e shërbimeve që ofrojnë për fëmijët me AK, *vëndin që ze shërbimi në drejtim të arsimit të tyre*, nivelin arsimor dhe specialitetin e stafit që ofron shërbime sociale, dokumentacionin që ato disponojnë, dhe çështje të tjera që lidhen *identifikimin dhe trajtimin e fëmijëve me AK*.

Nga intervistat me punonjësit e shërbimit social u mësua se:

- puna në sektorin e shërbimeve sociale konsiston vetëm në dhënien e ndihmave ekonomike për fëmijët me AK dhe familjet e tyre;
- ndihmë ekonomike u jepet vetëm atyre (ose përfaqësuesve) që paraqiten në ZSHS;
- përsa i përket shërbimeve të tjera që duhet të ofrojë sektori i shërbimeve sociale, sikurse problemet lidhur me arsimimin e fëmijëve me AK, punonjëset shprehen se nuk është detyrë e tyre; Ato përgjigjen vetëm për dhënien e ndihmës ekonomike që është vetëm 6.800 lekë/në muaj;
- Përsa i përket mënyrës se si i presin njerëzit, punonjëset përshkruajnë se administratori mbledh deklaratat mujore dhe merr konfirmimin në institucion, kurse përgjegjësi i zyrës sqaron njerëzit nga ana ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike për personat me AK;
- informacioni për identifikimin e fëmijëve me AK në ZSHS serviret nga mjeku rajonal, i cili duket se e pret fëmijën me probleme të shfaqet vetë në derën e klinikës mjekësore; PAK identifikohen në bazë të deklaratave familjare ku në një pikë kërkohet të dihet gjendja shëndetësore e fëmijës dhe pastaj bëhet verifikimi i drejtpërdrejt i tij;
- nuk ka persona të autorizuar nga zyra që të identifikojnë në terren personat me AK; theksohet se këtë rol nuk mund ta luaj asnjë nga punonjëset sociale sepse ato kanë shumë punë për të bërë brenda në zyrë;

- në zyrën e shërbimeve sociale ka dokumentacion të rregullt për të dhënat social-ekonomike të fëmijës;
- problemet me dokumentacionin rrjedhin nga përmbajtja e formularvë të cilët janë sipërfaqësor dhe nuk specifikojnë asgjë lidhur me anën shëndetësore të fëmijës;
- përveç një punonjëseje të zyrës së Librazhdit, asnjë nga punonjëset e tjera të shërbimit social nuk ka arsim përkatës; Ato janë të diplomuara në ekonomi agrare, madje njëra prej tyre nuk ka arsim të lartë por arsim të mesëm ekonomik;
- me terrenin merret administratori i rajonit por që nuk është në kompetencën e tij që të sinjalizojë për ekzistencën e fëmijëve me AK;
- shpesh listat për fëmijët me AK dhe probleme të tjera, i marrin nga shoqatat joqeveritare;
- nuk ka ndonjë rregullore pune për zyrën e shërbimeve sociale as në Elbasan as në Librazhd;
- përsa i përket bashkëpunimit të zyrës me drejtoritë e shkollave për fëmijët me AK, punonjëset shprehen se në raste të veçanta është vetëm një impenjim personal pasi ligji nuk përcakton asnjë detyrim për një bashkëpunim të tillë;
- lidhur me projektet e zyrës për shërbimet në arsimimin e fëmijëve me AK, punonjësit shprehen se nuk ka projekte të tilla, por vetëm në drejtim të ndihmë ekonomike. Për arsimin më shumë bashkëpunohet me shoqatat si MEDPAK, etj.

Nga një shqyrtim i hollësishëm i të dhënave të nxjerra nga intervista me punonjësit e zyrës sociale pranë bashkisë së rretheve Elbasan dhe Librazhd, del në pah se *asnjë nga punonjësit e ZSHS nuk merret me problemet e arsimimit të fëmijëve me AK*, duke lënë të kuptohet se askush nuk interesohet që ata të përfitojnë edhe të drejtën për arsimim. *Procedura e identifikimit të fëmijëve me AK, duket disi e paqartë* sepse ata që nuk kanë njohuritë e mjaftueshme për t'u drejtuar te mjeku që të pajisen me një raport mjekësor ose për arsye të ndryshme, nuk mund ta përfitojnë këtë raport, mbeten jo vetëm pa përkrahje ekonomike por edhe të paidentifikuar si persona me AK. (një rast të tillë e kam njohur personalisht në gjykatën e Elbasanit, i cili edhe pse ishte 13 vjeç nuk figuronte as në listën e ndihmës ekonomike as në regjistrat e shkollës, ishte shumë i varfër dhe analfabet. (V.Haxhiymeri). *Punonjëset e ZSHS nuk kanë arsim përkatës*, gjë që sjell konfuzion në përcaktimin e rolit dhe detyrave specifike të tyre, si dhe në cilësinë e shërbimit që duhet të ofrojë ky sektor jetik për fëmijët me AK dhe familjet e tyre. *Në ZSHS ka dokumentacion të rregullt*, por përmbajtja e formularëve të këtij dokumentacioni është sipërfaqësore dhe nuk specifikon asgjë për anën shëndetësore dhe arsimore të fëmijës me AK. Vetë *zyrat e shërbimeve sociale nuk ofrojnë informacion për shoqatat joqeveritare*, në të kundërt besojnë dhe pranojnë informacionin e ofruar prej këtyre të fundit. Mungojnë bashkëpunimet e ZSHS apo projektet e saj për të përmirësuar arsimimin e fëmijëve me AK. *Organizimi aktual i ZSHS nuk ofron shërbime për arsimimin e fëmijëve me AK.*

4.4 ROLI I DREJTORIVE PERKATESE TE MASH-së PER ZBATIMIN E LIGJIT PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRE

Asnjë reformë në arsim nuk mund të jetë e suksesshme pa bashkëpunimin reciprok mes organeve vendim-marrëse lokale dhe atyre qëndrore. Në këtë kontekst, MASH ka një rol të pazëvendësueshëm

në sigurimin e edukimit gjithpërfshirës në shkallë vendi. Përmes drejtorive përkatëse, sikurse ajo e *kurrikulave, statistikës dhe ekonomike*, MASH jo vetëm informohet për hapat e këtij procesi por edhe ndikon fuqishëm në progresin e tij.

Për të parë më nga afër angazhimin e MASH-së në procesin e zbatimit të ligjit për arsimimin e fëmijëve me AK, u zhvillua një intervistë me drejtuesit e drejtorisë së kurrikulave, statistikës dhe asaj ekonomike. Nga intervistat me ta u mësua se:

- në kurrikulat dhe programet lëndore të shkollës 9 vjeçare, si në lexim, dituri natyre, etj. nuk trajtohen probleme të gjithpërfshirjes dhe AK, me përjashtim të një pjese leximi ku trajtohet tema e përkrahjes dhe zhvillimit të qëndrimeve pozitive ndaj fëmijëve që përdorin syze.
- ende nuk ka një statistikë të detajuar për fëmijët me AK dhe problemet e tyre. Madje, kjo gjë nuk u kërkohet as sektorëve përkatës të ZA nëpër rrethe;
- në lidhje me buxhetin, mësuesit paguhen me normat e vitit 1994 dhe nuk ka buxhet për orët suplementare;

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se në tërësinë e dijeve dhe informacionit që parashikojnë programet e shkollës 9-vjeçare për edukimin e gjithanshëm të nxënësve, *njohuritë për AK dhe llojet e tyre, mungojnë*. Ndërkohë, që në lëndën e edukatës shëndetësore flitet shumë për drogën, alkolin, sidën, etj., në këtë lëndë nuk flitet aspak për aftësitë e kufizuara, të cilat mund të bëhen dukuri e prekshme edhe për moshën fëmijëve të shkollës 9-vjeçare, sepse shpesh shkak për AK bëhet një makinë, një teperaturë e lartë, poliomelit, etj. Gjithashtu, Drejtorja e Statistikës në MASH *nuk disponon një listë të fëmijëve me AK të përfshirë në shkollat e zakonshme*, dhe si rrjedhojë Drejtorja Ekonomike në MASH, *nuk mund planifikojë me saktësi buxhetin për kualifikimin dhe motivimin e mësuesve të shkollës së zakonshme të cilët punojnë me nxënës me AK*.

4.5 NIVELI I PËRGATITJES SE STUDENTEVE- MESUES PER SIGURIMIN NE VAZHDIMESI TE PROCESIT GJITHPERFSHIRES

Reformat që ndodhin në arsimin parauniversitar, zakonisht paraprihen nga kualifikime të mësuesve në shërbim, si dhe shoqërohen me përshtatje të nevojshme të programeve universitare që përgatisin mësues të rinj. Këto reflektime mundësojnë një garanci më të madhe për rritjen e cilësisë së shërbimeve në arsim.

Nisur nga kjo ide, *futja në sistem e arsimit gjithpërfshirës*, mbështetur tashmë edhe nga Dispozitat Normative për arsimin e detyruar 9-vjeçar, ka diktuar përpara universiteve shqiptare që të kompletojnë njohuritë dhe aftësitë e studentëve të degëve të ndryshme të mësuesisë, me qëllim që këta të fundit të dinë të përballen dhe të zbatojnë me sukses këtë risi.

Por, sa të përgatitur ndihen studentët-mësues për të punuar në një sistem arsimor gjithpërfshirës?

Për të mësuar më shumë rreth kësaj çështjeje, në studim u parashikua që fillimisht të zhvillohet një anketim me studentë të mësuesisë në fakultete të ndryshme të universitetit “Alksandër Xhuvani” në Elbasan. Përmbytja e fletë-anketave synonte të zbulonte jo vetëm *nivelin e njohurive të studentëve-mësues rreth nxënësve me aftësi të kufizuara, ligjit për arsimimin e tyre dhe edukimin gjithpërfshirës*, por edhe *nevojat teorike dhe praktike të tyre për të menaxhuar mësimdhënien në klasat e rregullta ku priten të përfshihen nxënësit me AK*. Anketimi u bë me vullnet të lirë dhe përfshiu 100 studentë të viteve të fundit të degëve të ndryshme të mësuesisë (50 studentë të cikli fillor dhe parashkollor, dhe 50 studentë të gjuhë-degëve letërsi, histori-geografi, bio-kimi, matematik-fizik). Kjo ndarje (50 me 50), ka të bëjë me faktin se studentët e

degës së ciklit fillor dhe parashkollor, janë të vetmit që zhvillojnë një lëndë të veçantë të titulluar Edukimi Special, gjë që tregon se këta studentë kanë avantazh në raport me studentët e tjerë përse i përket njohurive rreth aftësive të kufizuara dhe edukimit gjithpërfshirës. Për këtë arsye, përgjigjet e fletë-anketave të tyre u shqyrtuan më vehte, edhe pse formati i anketimit përfshinte të njëjtat pyetje si për të gjithë studentët e tjerë.

Përpunimi i të dhënave të nxjerra nga anketimi 50 studentëve të ciklit fillor dhe parashkollor, tregoi se:

- Pjesa më e madhe e studentëve dinin të përcaktonin sakt termin “nxënës me AK” duke përfshirë në përgjigje një gamë të gjërë paaftësish fizike, mendore dhe emocionale;
- 43 % e tyre pohojnë se kanë takuar nxënës me AK në klasat e rregullta ku kanë praktikuar;
- Shumica e studentëve tregojnë se nuk janë ndjerë të çuditur nga prezenca e fëmijëve me AK në klasat e rregullta, përkundrazi ata e vlerësonin në mënyra të ndryshme faktin që mësueset i kishin pranuar këta fëmijë në klasat e tyre, megjithëse ishte e vështirë të punoje;
- 67 % e studentëve pranojnë se vendi më i mirë për edukimin e fëmijëve me AK janë klasat e rregullta, 23 % cilësojnë klasat speciale dhe 10 % nuk prononcohen;
- Shumica e studentëve deklarojnë se nuk e njohin me hollësi përmbajtjen e ligjit por ata dinë se ligji favorizon arsimimin e fëmijëve me AK si në klasat speciale ashtu edhe në klasat të rregullta;
- Në përgjithësi, studentët deklarojnë se si mësues ata do t’i pranonin nxënësit me AK në klasat e tyre, por ata ende nuk dinë shumë se si të punojnë me ta për t’ju përgjigjur nevojave speciale;
- Lidhur me pyetjen se çfarë duhet ndryshuar në programet universitare lidhur me përgatitjen e studentëve në funksion të arsimit gjithpërfshirës, shumica e përgjigjeve thekson nevojën për përfshirjen në program të teknikave konkrete të mësimdhënies me fëmijët me AK, sepse në tekstet përkatëse përfshihen më tepër udhëzime të përgjithshme didaktike por jo specifike, p.sh. teknika praktike për të zhvilluar aftësitë sociale, motorike, gjuhësore, etj.;
- Përse i përket arsimit gjithpërfshirës, shumica e studentëve deklarojnë se ka të bëjë me rregjistrimin dhe pranimin e fëmijëve me AK në shkollat e rregullta;

Ndërsa, përpunimi i të dhënave nga anketimi i studentëve të degëve të tjera të mësuesisë të cilët nuk zhvillojnë ndonjë lëndë speciale në programin mësimor, evidentoi se:

- shumica e studentëve kanë një kuptim të qartë për aftësitë e kufizuara. Në këtë kontekst, ata *i përkufizojnë nxënësit me aftësi të kufizuara si persona të cilët ndeshin vështirësi* për të kuptuar, për të folur, shikuar, dëgjuar dhe shkruar. Madje shpesh në përgjigjet e tyre, këta nxënës kategorizohen si persona që *kanë nevojë për ndihmë dhe për një mësimdhënie të veçantë*;
- vetëm 20 % e studentëve pohojnë se *kanë ndeshur nxënës me AK gjatë praktikës së tyre*;
- ata që pohojnë se kanë ndeshur në praktikë nxënës me AK, shprehen gjithashtu se *janë ndjerë të çuditur për disa arsye*, së pari nga fakti pse këta nxënës qëndrojnë në klasat e rregullta, kur ka shkolla speciale; së dyti, ata shpesh fyheshin nga moshatarët; dhe së treti, mësueset e klasave të rregullta nuk gjenin kohë të mjaftueshme të merreshin me ta, kështu që gjenin si mënyrën më të

lehtë për t' i mënjeluar, duke i lënë në fund të bankës ose duke ua zënë kohën vetëm me vizatime;

- përsa i përket çështjes se cili është vendi më i mirë për edukimin e fëmijëve me AK, *vetëm 10 % e studentëve mendonin se vendi më mirë janë klasat e rregullta, përkrahë moshatarëve të tjerë normalë; 6 % e studentëve nuk u prononcuan, ndërsa 84 % e tyre, u shprehën në mënyrë kategorike se vendi më i përshtatshëm janë shkollat speciale;*
- asnjë nga studentët *nuk kishte dijeni se si shprehet ligji shqiptar për arsimimin e fëmijëve me AK;*
- të gjithë studentët-mësues *treguan gatishmëri për t' i ndihmuar fëmijët me AK, në rast se do të kishin të tillë në klasat e tyre të ardhshme; por në të njëjtën kohë ata përcillnin shqetësimin nëse do të mundeshin të ishin të dobishëm me këta fëmijë, sepse aktualisht u mungojnë njohuritë dhe teknikat për të punuar me ta;*
- lidhur me faktin se çfarë duhet përmirësuar më tej në përgatitjen e tyre për të qënë të suksesshëm edhe me fëmijët me AK, studentët sugjeruan se: duhen futur në lëndë të veçanta ose duhen zhvilluar kurse speciale ose në lëndët metodike duhen shtuar disa kapituj për punën me nxënësit me AK; Disa të tjerë sugjeruan se duhej praktikur më shumë edhe në këtë kuadër;
- ndërkohë *mungojnë ose janë të pasakta përgjigjet e studentëve rreth çështjes se kanë dëgjuar apo jo për “arsimin inkluziv ose gjithëpërfshirës” dhe se ç`do të thotë kjo për ta si mësues të klasave të rregullta.*

Në funksion të çështjes se sa të përgatitur ndihen studentët-mësues për edukimin gjithëpërfshirës, studimi e pa me vend të zhvillonte disa intervista me përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët e fakulteteve të degëve Cikli i Ulët dhe Parashkollor, Matematikë – Fizik dhe Bio – Kimi, Gjuhë – Letërsi, Histori – Gjeografi dhe Gjuhë të Huaja. Përmes këtyre intervistave u synua të mësohej se *ç`mendojnë rreth arsimit inkluziv pikërisht ata njerëz të cilët strukturojnë kurrikula dhe përgatisin programe për studentët-mësues. Përmbajtja kryesore e intervistave u përqëndrua në marrjen e një informacioni konkret për mënyrën se si është reflektuar në programet mësimore të degëve të mësuesisë futja në sistem e arsimit gjithëpërfshirës dhe çfarë nevojash kanë universitetet dhe stafi akademik për të rritur kulturën gjithëpërfshirëse në këto programe.*

Nga intervista me përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët e fakulteteve të mësuesisë u mësua se:

- Pak prej tyre pohuan se kishin dijeni për ligjin mbi arsimimin e fëmijëve me AK, për përmbajtjen e Dispozitës Normative të Arsimit Parauniversitar (dhjetor 2002) dhe futjen në sistem të arsimit gjithëpërfshirës; *Shumica u shprehën se kishin dëgjuar diçka rreth tyre por nuk kishin ndonjë kuptim të qartë për to;*
- Lidhur me pyetjen se cili ishte vendi më mirë sipas tyre, për edukimin e fëmijëve me AK, pak prej tyre pranuan shkollat e rregullta, shumica *deklaruan shkollat speciale;*
- Pasi u njohën me përmbajtjen e Dispozitës Normative për Arsimin Parauniversitar, të botuar në gazetën “Mësuesi” të datës 25.09.2002, veçanërisht me nenin 57/2 për arsimimin e nxënëve me nevoja të veçanta, *shumica e të intervistuarve i vlerësuan pozitivisht ndryshimet ligjore;*

- Pyetjes se sa të përgatitur pritet të jenë studentët-mësues për të përmbushur me sukses procesin gjithpërfshirës në arsim (të parashikuar tashmë edhe në dispozitën përkatëse) një pjesë e të intervistuarve shprehën se *studentët janë të përgatitur edhe për klasat gjithpërfshirëse* sepse të prodhosh një mësues cilësor do të thotë që *ky mësues të jetë i aftë të përfshijë në mësimdhënie efektive jo vetëm nxënësit që mësojnë mirë por edhe ata me vështirësi dhe probleme në të nxënë. Megjithatë, një pjesë tjetër theksojnë faktin që universiteti nuk përgatit mësues për shkollat speciale. Vetëm studentët e fakulteteve: cikli fillor, parashkollor dhe gjuhë-letërsi, klasifikohen nga të intervistuarit si me nivel përgatitje më të mirë lidhur me identifikimin dhe trajtimin edukativ të fëmijëve me AK.*
- Përsa i përket pyetjes se a ka lëndë specifike të pasqyruara në programet universitare, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve-mësues për mësimdhënien gjithpërfshirëse dhe fëmijët me AK, nga intervistat mësohet se: në degën e ciklit fillor dhe parashkollor zhvillohet një lëndë e veçantë e njohur si “*Edukimi Special*”; në degën gjuhë-letërsi zhvillohen disa lëndë të ngjashme me Edukimin Special, si *Terapi Ligjërimi, Psiko-linguistikë, Socio-linguistikë dhe Metodikë Gjuhe*; në degën bio-kimi jepen disa njohuri për aftësitë e kufizuara nëpërmjet lëndëve të përgjithshme si: *Anatomia, Fiziologjia, Gjenetika, Bioetika dhe Etiologjia*, por nuk jepen njohuri për trajtimin edukativ të tyre dhe arsimin gjithpërfshirës. Ndërsa, *në degët histori-geografi dhe matematikë-fizik, nuk jepen asnjë njohuri për aftësitë e kufizuara dhe arsimin gjithpërfshirës.*
- Për pyetjen se *cili do të jetë angazhimi i të intervistuarve për të ardhmen* në kuadër të arsimit gjithpërfshirës, përgjigjet janë premtuese, por ato shoqërohen me kërkesën se *stafi akademik ka nevojë për kualifikime në këtë fushë, për pjesmarrje në projekte të përbashkëta, tavilana të rrumbullakta dhe për botime në drejtim të zbatimit të edukimit special në klasat e rregullta.*

Nga analizua e të dhënave të mbledhura përmes anketimeve të studentëve të viteve të fundit të degëve të ndryshme të mësuesisë dhe intervistave me përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët e fakulteteve që përgatisin mësues, rezulton se në shkollat e larta që përgatiten mësues për ciklin e ulët dhe të lartë të shkollës 9-vjeçare, *Dispozita Normative për arsimimin e fëmijëve me AK, miratuar qysh në vitin 2002, njihet pak ose pjesërisht si nga stafi akademik drejtues ashtu edhe nga studentët. Në pjesën më të madhe të stafit drejtues reflektohet një kuptim i paqartë për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe arsimin gjithpërfshirës. Në programet e përgatitjes së mësuesve të rinj për lëndë të ndryshme të shkollës 9-vjeçare, janë përfshirë pak ose aspak lëndë të fushës së edukimit special, kurse leksionesh apo tema të veçanta për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe trajtimin edukativ të tyre në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. Angazhimi për të bërë ndryshime në drejtim të programeve dhe në kuadër lëndësh shihet premtues për të ardhmen, por për këtë qëllim nevojiten kualifikime të stafit drejtues të fakulteteve të mësuesisë, përfshirje e universiteteve në projekte për arsimin gjithpërfshirës dhe furnizimi me botime e libra në fushën e Aftësive të Kufizuara dhe trajtimin edukativ të tyre në klasat e rregullta. Ministria e Arsimit duhet të informojë rregullisht universitetet që përgatisin mësues për ndryshimet që pritet të ndodhin në nivelet parauniversitare të arsimit, dhe nga ana tjetër, vetë drejtuesit dhe ndërtuesit e kurrikulave të fakulteteve të ndryshme që përgatisin mësues për nivelin 9-vjeçar të shkollës së rregullt, duhet të lidhen më shumë me praktikën edukative dhe risitë që parashikohen të ndodhin atje. Universitetet duhen sensibilizuar për të kuptuar rëndësinë e futjes së arsimit gjithpërfshirës në nivelet edukative të detyrueshme, dhe të ndihmohen në parashikimin e ndryshimeve të nevojshme në kurrikulat dhe programet e tyre.*

5. MENDIME TE SPECIALISTEVE TE EDUKIMIT RRETH EFEKTIVITETIT TE ZBATIMIT TE LIGJIT PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRE

Zbatimi me efektivitet i kuadrit ligjor për arsimin gjithpërfshirës kërkon angazhimin e përbashkët të të gjitha hallkave përgjegjëse për vënien e tij në veprim. Në këtë kontekst, studimi e vlerësoi të domosdoshme të mblidhte në një tryezë të rrumbullakët, përfaqësues në nivel ekspertësh nga secila hallkë, për të diskutuar dhe planifikuar së bashku realizimin e arsimit gjithpërfshirës për PAK nën këndvështrimin e *Dispozitave Normative ekzistuese*. Diskutimi i përbashkët u parapri nga dy referime me temë: 1) “Përvoja rajonale e Librazhdit në edukimin e fëmijëve me AK në kuadër të arsimit gjithpërfshirës” (Z.Koka), dhe 2) “Aspektet kryesore që realizojnë arsimimin e fëmijëve me AK dhe fushat e ndërhyrjes në këtë drejtim” (V.Haxhiymeri). Këto tema patën si qëllim të njihnin pjesmarrësit me arritjeve rajonale të modelit gjithpërfshirës të realizuar në kuadër të projektit “Arsimi Special i Integruar”, si dhe të bënin prezente disa nga rezultatet paraprake të këtij studimi.

Ndërsa, përmbajtja e diskutimeve në tryezën e rrumbullakët u fokusua në konkretizimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve dhe përmirësimeve të domosdoshme në aspekte të veçanta ligjore dhe administrative për të realizuar arsimin gjithpërfshirës jo vetëm në rajonin e Librazhdit, por gradualisht edhe në rajone të tjera të vendit.

Prezenca e specialistëve të arsimit, të cilët iu përgjigjën pa hezitim ftesës për pjesmarrje në këtë tryezë të rrumbullakët, si dhe mendimet e shprehura prej tyre për zgjidhjen e problemeve dhe kapërcimin e vështirësive në procesin e gjithpërfshirjes, vlerësohen si një kontribut i rëndësishëm në arritjen e qëllimeve të këtij studimi, me poshte janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur diskutimin e secilit prej pjesmarrësve.

1. Z. Ilia Paluka, Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulave në MASH

Qeveria Shqiptare e ka pasur vazhdimisht në konsideratë edukimin e fëmijëve me AK. Tregues konkret i kësaj konsiderate është fakti që sot kemi një kuadër ligjor bashkëkohor për arsimimin e fëmijëve me AK, që i lejon ata të mësojnë si në shkollat speciale ashtu edhe së bashku me moshatarët e tyre në shkollat e zakonshme, si dhe Strategjitë Kombëtare për të konkretizuar arsimimin e tyre. Gjithashtu, në Universitetin e Vlorës po përgatiten mësues për edukimin special, ndërsa në shkollat e zakonshme sapo ka filluar eksperimentimi i futjes së shërbimit psikologjik që synon krijimin e një stukturë mbështetëse më të specializuar për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në këto shkolla. Natyrisht, nuk pretendohet se çdo gjë është arritur më së miri. MASH është në proces të vlerësimit dhe monitorimit të treguesve specifik të zbatimit të ligjit për arsimin gjithpërfshirës dhe në këtë kontekst, *ka në plan për të bërë ndryshime për përmirësimin e mëtejshëm të DN për Arsimin Parauniversitar dhe për vënien në efikasitet të strukturave zbatuese përkatëse.*

Lidhur me përfshirjen e njohurive për AK në kurrikula dhe tekste shkollimi, duhet shpjeguar se nuk i kemi në komandë. Autorët e teksteve shkollore janë të lirë në pjesët që zgjedhin. Aktualisht bëhet konkurs dhe fiton teksti që përmbush kriteret. Drejtoria jonë *do ta ketë parasysh që të shtojë si kriter përfshirjen e njohurive për AK në përgatitjen e teksteve shkollore.* Në këtë drejtim duhet të bëhet sensibilizimi i autorëve të teksteve për përfshirjen e fëmijëve me AK në klasat e zakonshme. Por, kjo mangësi në tekste mund të plotësohet mirë me *veprimtari edukative jashtëkurrikulare ose kroskurrikulare*, pra të mos i ngjeshim tekstet me pjesë të tjera shtesë.

Përsa i përket trajnimeve, mendoj të bëhet një seminar me të gjithë inspektorët e ZA për t'i orientuar për procesin gjithpërfshirës.

2. Z. Kasem Balla, Drejtor i ZA, Librazhd

Duhet të sigurohet ndërhyrje edukative më e hershme për fëmijët me AK. Në këtë kuadër, *procesi gjithpërfshirjes duhet të shtrihet* qysh në kopsht, pra në nivel parashkollor.

Duhet të parashikohet se kush nga mësuesit do të merret me përmbushjen e nevojave të veçanta të fëmijës me AK në shkollën e zakonshme dhe të përgatën këta mësues ose të specializohen për të qënë sa më efektiv. Duhet menduar mirë nëse ka nevojë për ndihmës mësues, veçanërisht për zonat e thella dhe për ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare ku përveç mësueseve femra, japin mësim edhe mësues burra të cilët krahasuar me të parat, nuk i kanë aq të kultivuara shprehitë e përkujdesit ndaj fëmijëve, për më tepër kur bëhet fjalë për një nxënës me AK.

3. Dr. Marita Nika, eksperte ne fushen e edukimit special dhe prind fëmije me AK

Duhet të rishikohet përkufizimi i aftësisë së kufizuar në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. Në këtë kontekst *nxënësi me AK duhet përkufizuar si nxënës që mëson ndryshe*. Gjithashtu të përcaktohen qartë kategoritë e aftësisë së kufizuar.

4. Z. Alqi Çabiri, Përgjegjës i Zyrës së Kualifikimit në DRA, Elbasan

Problemi qëndron jo tek përmbajtja ligjore e Dispozitës Normative por tek *mosrealizimi i saj në praktikën edukative*. Për të rritur efektivitetin e zbatimit të DN duhet ndërhyrë në trajnimin e mësuesve për të kuptuar thelbin e edukimit special të integruar. Gjithashtu, të ndihmohen mësuesit me botime në fushën e edukimit gjithpërfshirës dhe të rritet sensibilizimi i tyre duke përdorur mjete të ndryshme, përfshi edhe fletëpalosjet.

5. Z. Vladimir Pasku, përfaqësues nga Drejtoria e Inspektimit në MASH

Nuk kemi tregues të efektivitetit të zbatimit të Dispozitës Normative gjë që duhet ta bëjë Drejtoria e Inspektimit në MASH. Standardet kanë të bëjnë me kujdesin për nxënësit. Përsa i përket kujdesit për fëmijët me AK, këtë vit kemi mbledhur të dhëna për fëmijët me epilepsi. Për të siguruar zbatimin me efektivitet të DN, duhet rritur bashkëpunimi me Drejtorinë e Inspektimit.

6. Z. Rexhep Çuko, Drejtor i Zyrës së Statistikës, në MASH

Mungon baza e të dhënave për fëmijët me AK të përfshirë ose jo në shkollat e zakonshme. Të dhënat ekzistojnë vetëm për shkollat speciale. Për të kapërcyer këtë problem duhen përcaktuar treguesit që do të përbëjnë bazën e të dhënave. Por, për të përgatitur këtë bazë të dhënash duhet që të ngrihet urgjentisht një grup pune në MASH. Në këtë drejtim, duhet të bashkëpunohet me DRA të cilës nuk i mungojnë mjetet elektronike për të realizuar atë që thamë më lartë.

7. Znj. Daklea Shtylla, Drejtore e Shërbimeve në Bashkinë e Tiranës

Bashkia e Tiranës ka bërë një studim për PAK dhe ka mbledhur të dhëna rreth tyre, mes të cilave edhe të dhënat e 2129 fëmijëve me AK deri në 18 vjeç. Por nuk mjaftojnë vetëm të dhënat për fëmijët me AK, duhet të kategorizohen llojet e AK dhe këtë gjë mund ta bëjë mjeku ose dikush tjetër.

Gjithashtu, Bashkia e Tiranës ka krijuar një sektor të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ku punojnë dy punonjës. Ka ardhur koha që të targetohet një grup pune në një njësi bashkiake për të

ndjekur problemet e fëmijëve me AK lidhur me arsimimin e tyre.

Për të punuar më me efektivitet në këtë drejtim, është mirë që shkolla “Luigj Gurakuqi”, numri i nxënësve të së cilës ka ardhur duke rënë nga viti në vit, *të kthehet në një institucion ku të bëhet edhe vlerësimi i fëmijëve me AK*. Kjo shkollë mund të shërbejë dhe si Qendër Burimore Multidimensionale.

Institucionet shtetërore përkatëse duhet të analizojnë boshllëqet në zbatimin e ligjit për arsimin gjithpërfshirës dhe të marrin përsipër përgjegjësitë që u takojnë.

Ne si bashki bëjmë planifikime dhe japim shërbime për fëmijët me AK, por projektet gjithpërfshirëse duhen ndërmarrë nga MASH dhe DRA.

8. Znj. Eglantina Lika, Inspektore e Arsimit Parashkollor në DRA, Tiranë

Në kopshtet e Tiranës është realizuar një projekt për integrimin e fëmijëve me AK, financuar nga shoqata “Ndihamoni Jetën”. Por nevoja për ndërhyrje të hershme nuk plotësohet vetëm me një projekt. *Duhet të shtohen kopshtet gjithpërfshirëse.*

9. Z. Vladimir Xhelili, Drejtues i Fakultetit Pedagogji e Specializuar, në Universitetin e Vlorës

Në Universitetin e Vlorës po përgatiten 24 studentë për të punuar me fëmijët me AK. Ata do të shërbejnë si *mediator social* që do të punojnë nën moton: *Të njejtë në të drejta dhe të ndryshëm në nevoja.*

Por, *duhen motivuar mësuesit e rinj* që të rritet edhe numri i rregjistrimit të tyre në këtë degë. Për këtë duhet të rishikohet në DN stimulimi material mësuesve të edukimit special.

Lidhur me zbatimin e ligjit për arsimin gjithpërfshirës duhet ndërmarrë një *fushatë sensibilizimi, ndërgjegjësimi dhe trajnimi me prindërit që kanë fëmijë me AK dhe mësuesit e shkollës së zakonshme.*

Integrimi i fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme nuk mund të zgjidh përfundimisht problemet e tyre. Në këtë kontekst duhen *mbështetur edhe format e tjera të edukimit dhe trajtimit* të tyre, si: shkollat speciale, klasat speciale brenda shkollës së zakonshme, edukimi në shtëpi, qendrat ditore.

10. Z. Fatmir Bezati, inspektor në Drejtorinë e Kurrikulave në MASH.

Problemi imediat është se sa po zbatohet aktualisht ligji për arsimin gjithpërfshirës dhe si do ta zbatojmë atë në ardhmen. Pra, *duhen gjetur gjetur rrugët dhe mjetet e përshtatshme për ta bërë plotësisht të zbatueshëm ligjin ekzistues.*

6. PERFUNDIMET E STUDIMIT

1. Dispozita Normative për Arsimin Parauniversitar, miratuar në dhjetor 2002, shpreh për herë të parë tendencën bashkëkohore të integritit të fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme, kundrejt veçimit të tyre në institucione speciale, dhe shpall si të domosdoshëm arsimin gjithpërfshirës. Në të parashikohen një sërë detyrimesh ligjore në adresë të shkollës së zakonshme që kanë të bëjnë me rregjistrimin e fëmijëve me AK, zbatimin e planit mësimor, programeve lëndore, teksteve, vlerësimin e nxënësve me AK, kalimin e tyre pa mbetje, etj.
2. Kuadri ligjor që shpreh DN për arsimimin e fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme, vlerësohet si mjaft i përparuar, demokratik dhe i krahasueshëm me standardet e vendeve të zhvilluara. Gjithashtu, zbatimi i tij nga MEDPAK në kuadër të projektit rajonal “Arsimi Special i Integruar” tregoi se ky kuadër ligjor është efektiv, i përshtatshëm dhe i vlefshëm për kushtet e shkollës shqiptare. Tregues kryesor në këtyre cilësive, janë gjenerimi i një model rajonal të arsimit gjithpërfshirës, si dhe përfitimet e gjëra arsimore, sociale dhe ekonomike që rrodhën nga zbatimi i tij. Në të njejtën kohë, projekti tregoi edhe rrugët e mjetet për ta bërë ligjin plotësisht të zbatueshëm.
3. Në fakt, shkolla e zakonshme shqiptare është dashamirëse ndaj fëmijëve me AK por ajo ende nuk është gati për t’u ofruar atyre shanse të barabarta arsimimi. Edhe pse marrëdhënia edukative e saj me këtë kontigjent nxënësish specifikohet juridikisht në DN për Arsimin Parauniversitar (dhjetor 2002), ajo ndesh vështirësi në njohjen, kuptimin dhe zbatimin me korrektësi të kësaj dispozite. Në këtë kuadër, praktika shkollore vëren se ka paqartësi ligjore në lidhje me procedurat e pranimit, vlerësimit fillestar dhe rregjistrimit të fëmijëve me AK në klasën e parë. Mungojnë aktet normative që rregullojnë punën e mësuesve me PEI –në. Në kuadrin ligjor për arsimin nuk gjejnë shprehje të plotë dhe aspak motivuese, çështje të tilla si kualifikimi i mësuesve, ngarkesa mësimore e tyre dhe vlerësimi financiar. Nuk saktësohet juridikisht marrëdhënia mes shkollës së zakonshme dhe sistemit të shërbimeve sociale. Nuk janë krijuar strukturat mbështetëse në MASH, DRA dhe në drejtoritë e shkollave, që të mund të sigurojnë koordinimin dhe mbarëvajtjen e procesit të integritit dhe gjithpërfshirjes në arsim. Kurrikula shkollore, programet mësimore dhe tekstet e shkollës së zakonshme nuk i përshtaten arsimit gjithpërfshirës. Mungojnë mjediset e përshtatshme në shkollën e zakonshme, mungojnë qendrat burimore, mjetet dhe materialet e tjera të nevojshme për procesin gjithpërfshirës. Në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare, juridikisht është e paqartë mënyra se si do të zbatohet ligji për arsimin gjithpërfshirës.
4. Ndërhyrja e hershme ende nuk gjen shprehje në kuadrin ligjor, ndërkohë që praktikat gjithpërfshirëse në nivel kopshti kanë filluar të zhvillohen në kuadër projektesh.
5. Marrëdhëniet shoqërore dhe qëndrimet e nxënësve të tjerë ndaj nxënësve me AK në përgjithësi shfaqen miqësore, veçanërisht në moshat e vogla këto marrëdhënie karakterizohen si më dashamirëse dhe pranuese, ndërsa me rritjen e fëmijëve në moshë, marrëdhëniet reflektojnë diferenca gjinore dhe shfaqen jo aq pranuese sa më parë. Në këtë drejtim, ndikon edhe mungesa e njohurive që kanë nxënësit e shkollës së zakonshme për AK dhe llojet e tyre. Përmbajtja e programeve lëndore dhe tekstet në shkollat e zakonshme nuk përfshijnë njohuri për AK, ndërkohë që AK përbëjnë një rrisht të ngjashëm me sidën, alkolin, drogën, etj. që mund të prekin këdo, vetëm se në këtë rast shkak mund të bëhet një temperaturë e lartë, një aksident, etj.
6. Sensibilizimi dhe kualifikimi i cili duhet t’i paraprijë procesit të gjithpërfshirjes në arsim, ka rezultuar vetëm në shkollat e përfshira në projekt dhe ka pushur bashkë me projektin. Ndërsa, mësuesit e

shkollës së zakonshme të papërfshirë në projekt, drejtuesit e tyre dhe vetë stafi i sektorit kualifikues në DAR dhe ZA, nuk kanë marrë informimin dhe kualifikimin e nevojshëm. Në këtë kontekst, shumica e mësuesve të papërfshirë në projekt tregojnë se nuk e njohin plotësisht kuadrin ligjor për arsimimin e fëmijëve me AK, nuk kanë njohuri rreth AK dhe llojeve të tyre, nuk zotërojnë teknikat mësimdhënëse specifike për të punuar me këta nxënës, nuk dinë si të veprojnë në raste të veçanta, s'kanë siguri për përshatjen e programit mësimor dhe se sa duhet ta thjeshtojnë atë për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve me AK, etj. Nga ana tjetër, drejtuesit e shkollës së zakonshme edhe pse orientojnë mësuesit që të pranojnë në klasat e tyre nxënës me AK, nuk ndihen të fuqishëm për të ndjekur në vijimësi procesin e gjithpërfshirjes së këtyre nxënësve, si dhe të mbështesin e të motivojnë mësuesit në këtë proces. Stafi i ZA, sektori i kualifikimeve ka vështirësi profesionale dhe financiare për të siguruar kualifikim cilësor për mësuesit dhe drejtuesit e shkollës. Ndërsa sektori i statistikave nuk disponon listë me emrat dhe të dhëna të tjera për fëmijët me AK që mësojnë në klasat e zakonshme.

7. Niveli arsimor i prindërve të cilët kanë fëmijë me AK rezulton shumë i ulët. Nga ana tjetër, familjet e tyre kanë nevoja ekonomike të mëdha dhe vëmëndja e tyre përqëndrohet më shumë në plotësimin e këtyre nevojave se sa në përmbushjen e të drejtës së fëmijës me AK për t'u arsimuar. Si rrjedhim, bashkëpunimi i shkollës me ta për mirëritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me AK parashikon vështirësi të mëdha. Megjithatë, dashuria e prindërve për fëmijët e tyre me AK është e pakufishme dhe ata shfaqin gatishmërinë të bëjnë gjithçka që mundin për fëmijët e tyre.
8. Shërbimi psikologjik sapo është shtrirë në shkollat e zakonshme dhe vlerësohet si një hap i rëndësishëm për procesin e gjithpërfshirjes. Specialistët e këtij shërbimi aktualisht mbulojnë 3-4 shkolla, ndërkohë që pohojnë se numri i madh i shkollave përbën një problem që ndikon në uljen e efektivitetit të shërbimit psikologjik. Gjithashtu, ata nuk kanë njohje për AK dhe trajtimin psikologjik të llojeve të tyre. Shumica e psikologëve ofrojnë vetëm këshillim individual ose në grup. Ata tregojnë se janë diplomuar për mësuesi dhe kanë nevojë për kualifikime në planin teorik dhe praktik të dhënies së shërbimit psikologjik.
9. Organizimi i punës në ZSHS nuk përfshin trajtimin e problemeve të arsimimit të fëmijëve me AK. Procedurat e regjistrimit të fëmijëve me AK janë të paqarta dhe përmbajtja e formularëve të tyre është sipërfaqësore në lidhje me specifikën shëndetësore dhe arsimore të çdo fëmije me AK. Punonjëset e ZSHS nuk kanë arsim përkatës. Mungojnë projekte për të ardhmen lidhur me ndjekjen e problemeve të arsimimit të fëmijëve me AK.
10. MASH nuk ka caktuar buxhet për kualifikimin e mësuesve të shkollave të zakonshme në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. E njëjta situatë rezulton me buxhetin edhe për pagesën e orëve suplementare. Gjithashtu, MASH nuk ka statistika të fëmijëve me AK që mësojnë në klasat e zakonshme.
11. DN njihen pak ose pjesërisht si nga stafi akademik që drejton fakultetet që përgatisin mësues të rinj ashtu edhe nga vetë studentët-mësues. Në programet që përgatisin mësues për ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare janë përfshirë pak ose aspak lëndë të fushës së edukimit special. Universiteti premton se në të ardhmen do të angazhohet për të bërë ndryshime pozitive në drejtim të programeve lëndore, por stafi akademik ka nevojë për sensibilizim, për kualifikim, për përfshirje në projekte dhe furnizim me libra në fushën e aftësisë së kufizuar dhe arsimit gjithpërfshirës. Universitetet që përgatisin mësues ndihen të painformuara mirë për ndryshimet dhe reformat që ndodhin në arsimin parauniversitar. MASH ka përgjegjësinë e saj në këtë drejtim.

7. FUSHAT E NDERHYRJES PER TE RRRITUR EFEKTIVITETIN E ZBATIMIT TE LIGJIT PER ARSIMIN GJITHPERFSHIRE

Hapi final i studimit të prezantuar në këtë raport është *përcaktimi i fushave të ndërhyrjes për të rritur efektivitetin e zbatimit të kuadrit ligjor për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kushtet e arsimit gjithpërfshirës*. Përfundimet e studimit dhe idetë e shprehura në tryezën e rumbullakët orientojnë nevojën për ndërhyrje imediate në fushat e mëposhtme:

1. Kuadri ligjor ekzistues

- Duhet rishikuar përkufizimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. Në këtë kontekst nxënësi me AK duhet përkufizuar si nxënës me që “mëson ndryshe”.
- Të kategorizohen qartë llojet e aftësive të kufizuara.
- Të përshkruhen qartë procedurat ligjore për pranimin, vlerësimin fillestar dhe rregjistrimin e fëmijëve me AK në klasën e parë të shkollës së zakonshme.
- Të rishikohen aktet normative që rregullojnë punën me PEI.
- Të përmirësohen shërbimet mbështetëse për mësuesit si: ulje e normave mësimore, futja e një asisteti i cili mund të jetë edhe një mësues që ka dalë në pension por që ndihet i aftë për të kontribuar për shkollën, stimulimi përmes pagesës dhe formave të tjera të shpërblimit dhe stimulimit brenda shkollës, etj.).
- Të parashikohet në legjisllacion se si do të procesojë arsimit gjithpërfshirës në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare dhe si do të motivohen mësuesit që japin mësim në një klasë gjithpërfshirëse. E njëjta gjë duhet bërë edhe për arsimin parashkollor, pavarësisht se ky nivel nuk është i detyrueshëm. Fakti që ka projekte gjithpërfshirëse edhe në këtë nivel edukimi, do të thotë se duhet parashikuar në dispozita të veçanta se çdo të bëhet të ardhmen me këtë përvojë dhe si do të veprohet për ta çuar më tej.
- Përshtatja e kurrikulave, programeve lëndore dhe teksteve për arsimin gjithpërfshirës duhet të parashikohet në ligj se kush duhet ta bëjë dhe si është më mirë të bëhet, ose sa duhet thjeshtuar dhe si duhet përshtatur.
- Kuadri ligjor duhet të shoqërohet me akte nënligjore që vihen në lëvizje në rast se ligji nuk zbatohet.

2. Shkolla e zakonshme (mësuesi, drejtuesit e shkollës së zakonshme, specialistët e shërbimit psikologjik)

- Nevojitet që të sensibilizohen dhe të ndërgjegjësohen mësuesit e shkollës së zakonshme dhe drejtuesit e tyre për rëndësinë e arsimit gjithpërfshirës.
- Nevojitet që të bëhen trajnime teorike dhe praktike për mësuesit e shkollës së zakonshme dhe drejtuesit e tyre, lidhur me njohjen e DN për edukimin e fëmijëve me AK në kuadër të arsimit gjithpërfshirës, për njohjen e AK, llojet e tyre dhe mënyrat e trajtimit edukativ, për përgatitjen e PEI-së dhe zotërimin e teknikave të mësimdhënies gjithpërfshirëse në klasat e rregulta.
- Nevojitet që të bëhen trajnime të mësuesve për t'u bërë më të vetëdijshëm për bashkëpunimin me prindërit dhe të mbështeten për të zhvilluar plane efektive të punës me prindërit me qëllim që ndihma e këtyre të fundit të mos mbetet vetëm në shtëpi por të konsistojë edhe në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të tyre në klasë.

- ❑ Të ndihmohen mësuesit me botime teorike dhe praktike në fushën e edukimit gjithpërfshirës.
- ❑ Të realizohet motivimi i mësuesit në bazë të legjislacionit ekzistues.
- ❑ Të rritet roli i drejtorisë së shkollës së zakonshme në drejtim të mbështetjes profesionale dhe motivimit të mësuesve që punojnë me nxënësit me AK. Të programojnë së bashku me mësuesit veprimtari jashtëkurrikulare dhe kroskurrikulare për të rritur njohuritë e nxënësve rreth AK.
- ❑ Të mendohet gradualisht për të rregulluar ambjentet e shkollës, për të ngritur qendër burimore në mbështetje të punës së mësuesve dhe për t'i furnizuar ata me mjete dhe materiale të nevojshme për procesin gjithpërfshirës.
- ❑ Të inkurajohen të bashkëpunojnë me komunitetin e biznesit dhe pushtetin vendor për të siguruar mjedise të përshtatshme në shkollë, të komletuar qendrën burimore dhe materiale të tjera të nevojshme për procesin gjithpërfshirës.
- ❑ Të ndihmohen specialistët e shërbimit psikologjik në shkollat e zakonshme me trajnime dhe kualifikime në fushën e edukimit special dhe arsimit gjithpërfshirës, si dhe me uljen e numrit të shkollave ku ata shërbejnë, me qëllim që të rritet efektiviteti i shërbimeve të tyre të parashikuara në dokumentet përkatëse të MASH.

3. Familja (prindërit dhe të afërmit e tyre)

- ❑ Niveli i ulët arsimor i prindërve që kanë fëmijë me AK është një tregues i problemeve arsimore në vazhdimësi, por në të njëjtën kohë është një apel për shkollën e zakonshme dhe institucionet e tjera mbështetëse, që të sigurojnë edukimin prindëror përpara se t'i ftojnë ata që të bëhen partnerë efektivë dhe punojnë për të njëjtin qëllim – edukimin dhe arsimimin më të mirë të fëmijëve në përgjithësi dhe atyre me AK, në veçanti.
- ❑ Duhet përcaktuar strategji të qarta dhe të mbështetura fonde të studiuara mirë për të realizuar punën me prindërit e fëmijëve me AK dhe përfshirjen e tyre si mbështetës të rëndësishëm të procesit të gjithpërfshirjes
- ❑ Mësuesit duhet të aktualizojnë planet e punës me prindërit e nxënësve të tjerë, në mënyrë që t'i përgjigjen ndryshimeve arsimore të shkollës dhe kohës që jetojmë.
- ❑ Shoqatat rajonale të prindërve që kanë fëmijë me AK duhet të bëhen më aktivë në rolin e tyre dhe të angazhohen për të ndihmuar dhe mbështur njëri-tjetrin, veçanërisht prindërit e paarsimuar për t'u bërë prindër më kompetentë.
- ❑ Shumica e familjeve që kanë fëmijë me AK jetojnë në një ekonomi të tepër të rënduar, gjë që e sponson vëmendjen e tyre në sigurimin e nevojave për të jetuar dhe lënë jashtë vëmendjes arsimimin e fëmijëve me AK. Për këtë arsye duhet ndërhyrje nga pushteti vendor, shoqatat joqeveritare dhe vetë komuniteti për të lehtësuar dhe përmirësuar gjendjen ekonomike të rënduar të tyre. gjithashtu, Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale duhet parashikojë strategji më efektive për punësimin e familjarve të personave me AK dhe për dhënien e ndihmës së nevojshme.

4. Drejtoria Rajonale e Arsimit dhe Zyrat Arsimore

- ❑ Duhet përpiluar menjëherë listat e rregullta me të dhënat soecifike të çdo fëmije me AK të përfshirë në shkollën e zakonshme. DRA dhe ZA e disponojnë teknologjinë kompjuterike për të përgatitur dhe ruajtur të dhënat bazë për fëmijët me AK që ndjekin shkollën e zakonshme.

- ❑ Në tërësinë e buxhetit, duhen parashikuar fonde për rritjen e numrit të kualifikimeve të mësuesve dhe cilësinë e tyre, për përgatitjen e literaturës ndihmëse dhe guidave praktike që sigurojnë procesin gjithpërfshirës.
- ❑ Duhet kualifikuar vetë stafi i DRA dhe ZA për të qënë të qartë dhe të aftë në procesin e monitorimit dhe mbështetjes së procesit gjithpërfshirës.
- ❑ Të mbështetet DRA dhe ZA për të realizuar sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e mësuesve për rëndësinë dhe përshpejtimin e procesit gjithpërfshirës.
- ❑ Të orientojë praktikisht rolin e specialistëve të shërbimit psikologjik në shkollat e zakonshme në kuadër të arsimit gjithpërfshirës.
- ❑ Të rrisë bashkëpunimin me MASH, ZSHS, shoqatat joqeveritare dhe stafin akademik të universiteteve që përgatisin mësues të rinj.

5. Autoritetet vendore dhe Zyrat e Shërbimit Social dhe Ndihmës Ekonomike

- ❑ Duhet të rritet vëmendja dhe mbështetja e autoriteteve vendore edhe në drejtim të realizimit të të drejtës së fëmijëve me AK për t' u arsimuar.
- ❑ ZSHS në bashkinë e qytetit duhet të riorganizohet dhe të përfshijë në punën e saj edhe ndjekjen e problemeve arsimore të fëmijëve me AK. Në këtë drejtim ajo duhet të bashkëpunojë më shumë me shkollat e zakonshme, DRA ose ZA, si dhe me shoqatat.
- ❑ Punonjësit e ZSHS duhet të jenë të diplomuar në fushën e shërbimeve sociale, në të kundërt kualifikimet do të ishin të pamjaftueshme për të kryer si duhet rolin e tyre në raport me tërë spektrin e problemeve që shoqërojnë PAK, dhe veçanërisht fëmijët me AK.
- ❑ Duhet të përpilojnë lista të PAK dhe të pasqyrojnë në mënyrë të detajuar të dhënat rreth tyre.
- ❑ Të përmirësohet procesi i identifikimit të PAK dhe të mos pritët në zyrë që ata të paraqiten vetë, sepse ka prej tyre që nuk janë me dije se ekziston një zyrë e shërbimeve social-ekonomike që pret t' i ndihmojë ata.

6. MASH

- ❑ Kërkohet ndërhyrje nga MASH për të vënë efikasitet tërë mekanizmat dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e ligjit për arsimin gjithpërfshirës.
- ❑ MASH duhet të sigurojë ndërhyrjen e hershme arsimore të fëmijëve me AK. Kopshtet duhet të jenë po aq të përgatitura sa dhe shollat e zakonshme për të pritur he arsimuar fëmijët me AK.
- ❑ Integrimi i fëmijëve me AK në klasat e zakonshme, sigurisht që nuk mund të zgjidh tërë problemet e fëmijëve me AK. Në këto rrethana MASH duhet të mbështesë edhe format e tjera të edukimit dhe trajtimit të tyre si: shkollat speciale, klasat speciale brenda shkollave të zakonshme, edukimin në shtëpi, qendrat ditore, etj.
- ❑ Drejtoria e kurrikulave në MASH duhet të ndërhyjë në përshtatjen e kurrikulës shkollore, programeve mësimore dhe teksteve të shkollës së zakonshme për t' i bërë ato efektive në duart e mësuesve që punojnë me nxënës me AK.
- ❑ Në përgatitjen e teksteve shkollore duhet vendosur si kriter dhe duhen orientuar autorët e librave

që të përfshijnë në përmbajtjen e teksteve mësimore edhe njohuri për AK.

- Drejtorja e statistikave në MASH duhet të nxitojë në përgatitjen e listave me emrat dhe të dhënat bazë të çdo fëmije me AK të përfshirë në shkollat e zakonshme dhe në kopshte.
- Drejtorja Ekonomike në MASH duhet të parashikojë në mënyrë të studjuar mirë dhe të përcaktojë buxhetin e nevojshëm për kualifikimin e mësuesve në kuadër të arsimit gjithpërfshirës, dhe të sigurojë motivimin e tyre të parashikuar në DN të Arsimit Parauniversitar. Në këtë drejtim duhet ndërhyrje e shpejtë edhe për mësuesit e ciklit të lartë të shkollës 9-vjeçare si dhe për mësueset për parashkollor të cilat kanë përfshirë në klasat e tyre nxënës me AK.

7. Universitetet që përgatisin mësues të rinj

- Duhet sensibilizuar stafi akademik i universiteteve për futjen në sistem të rrisë gjithpërfshirëse në arsimin e detyruar 9-vjeçar me qëllim që të ndërhyhet sa më shpejt, për të përmirësuar kurrikulat dhe programet lëndore të përgatitjes së mësuesve të rinj, veçanërisht të atyre që do të japin mësim në ciklin e lartë të shkollës 9-vjeçare.
- Duhet parashikuar trajnime për stafin akademik të universiteteve, në kuadër projektesh nga shoqatat joqeveritare të interesuara për arsimin gjithpërfshirës ose nga MASH, për të njohur DN të Arsimit Parauniversitar dhe nevojat e shkollës së zakonshme në këtë aspekt.
- Duhet angazhuar në projekte të përbashkëta për arsimin gjithpërfshirës, si dhe të furnizohen me botime e libra në fushën e AK dhe trajtimin edukativ sipas specifikave të tyre.

8. REKOMANDIME

Duke u marrë në konsideratë përfundimet e studimit, mendimet e specialistëve të edukimit dhe fushat e ndërhyrjes për të siguruar arsimimin e fëmijëve me AK në kuadër të arsimit gjithpërfshirës, grupi i studimit rekomandon:

- Të krijohet një zyrë avokatie me suport të nevojshëm për të marrë në shqyrtim në mënyrë profesionale nevojat aktuale në lidhje me *përmirësimin në vazhdimësi të kuadrit ligjor për arsimin e PAK* ose për të plotësuar me amendamente të reja legjisllacionin për arsimimin e fëmijëve me AK, si dhe për të ndjekur shkallën e ekzekutimit ose të zbatimit të ligjeve në të gjitha strukturat dhe hallkat e arsimit.
- Të krijohen *strukturat e nevojshme pranë MASH, DAR, ZA dhe qeverisjes vendore, të cilat do të kenë përgjegjësi specifike për të mbështetur dhe siguruar arsimimin e fëmijëve me AK* në kuadër të arsimit gjithpërfshirës. Në këtë kuadër, duhet t'i jepet rëndësia e duhur *ndërhyrjes së hershme në arsimimin e fëmijëve me AK* dhe të përgatitet kuadri ligjor dhe mekanizmat e tjerë mbështetës për realizimin me sukses të këtij procesi.
- Të stimulohet perpjekja përngritjen e nje *grupi pune në nivel ekspertësh për të thelluar studimin në shkallë vendi, mbi nevojat reale dhe mundësitë konkrete të shkollës së sotme për të përballuar gradualisht implementimin e arsimit gjithpërfshirës, për të rritur nivelin e përshtatshmërisë praktike të këtij procesi dhe për të përcaktuar paraprakisht prioritetet dhe koston për mbarëvajtjen e tij në vazhdimësi.*
- Të zhvillohet *një paketë kombëtare për mësimdhënien dhe të mësuarit në shkollat gjithpërfshirëse dhe të vihet në dispozicion të institucioneve trajnuese si DAR, ZA dhe lektorëve të universiteteve të cilët aktualisht kanë pak përvojë në këtë fushë.*

- ❑ Të hartohen *plane veprimi të shoqëruara me fondet përkatëse për të mbështetur në mënyrë cilësore dhe imediate trajnimin* e mësuesve, drejtuesve të shkollave, specialistëve të shërbimit psikologjik, punonjësve socialë dhe prindërit e fëmijëve me AK.
- ❑ Të përpilohen statistika të hollësishme për fëmijët me AK, dhe kjo punë duhet të fillojë në MASH dhe në ZA të rretheve.
- ❑ MASH duhet të rishikojë zerat e përdorimit të buxhetit për kualifikimin dhe motivimin e mësuesve të shkollave të zakonshme të cilët punojnë me nxënës me AK.
- ❑ Të hartohet *një kurrikul që t'i përgjigjet arsimit gjithpërfshirës*, të zhvillohen programe më fleksibël, të modelohen strategji e metoda më efikase, si dhe të sigurohen *tekste alternative dhe standarde* të arritjes lëndore për nxënësit me AK.
- ❑ Të mbahet parasysh *në projektimet e reja dhe rikonstruksionet në vazhdimësi të shkollave të zakonshme* që të sigurohen mjedise fizike të brendshme dhe jashtme, që favorizojnë dhe lehtësojnë qëndrimin dhe lëvizjen e nxënësve me AK. Gjithashtu, tëmbahet parasysh që të projektohen brenda mjediseve të shkollës së zakonshme hapësira të mjaftueshme për *krijimin e klases speciale dhe qendrës burimore* që do të mbështesë funksionet e reja të shkollës dhe do të plotësojë nevojat e saj me libra, mjete, materiale, informacion koherent, asistencë, etj.
- ❑ Të *kualifikohen psikologët* e përfshirë në shkollat e zakonshme dhe *shtohet numri i tyre* duke synuar një psikolog për shkoll, me qëllim që të rritet cilësia e shërbimeve në kuadër të arsimit gjithpërfshirës.
- ❑ MASH dhe MPCÇS, së bashku me autoritetet vendore duhet të zhvillojnë *takime të rregullta për të koordinuar dhe siguruar zhvillimin e politikave në lidhje me arsimimin dhe punësimin e fëmijëve me AK.*
- ❑ *ZSHS duhet të riorganizohen* dhe të përfshijnë në veprimtarinë e tyre edhe ndjekjen e problemeve arsimore të fëmijëve me AK dhe të bashkëpunojnë në këtë drejtim me shkollat e zakonshme.
- ❑ Të *përgatiten botime* që bëjnë me dije mësuesit dhe profesionistët e tjerë rreth çështjeve teorike dhe praktike të arsimit inkluziv, si dhe që i mbajnë ata në koherencë me ecurinë e këtij procesi.
- ❑ Të *shfrytëzohen mediat dhe mjete të tjera të larmishme për ndërgjegjësimin në masë* të mësuesve, nxënësve, prindërve, drejtuesve, autoriteve dhe mbarë shoqërisë për dobinë personale dhe sociale të zbatimit të arsimit gjithpërfshirës.

REFERENCAT

- Cenaliu, L.* *Si t'i identifikojmë dhe trajtojmë fëmijët me aftësi të kufizuara. Probleme Psiko-Pedagogjike e Sociale (f. 63-72, v. 5). Botim i Institutit te Studimeve pedagogjike2004)*
- MASH* *Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2001-2005, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, (20 nëntor 1989), botuar në Tiranë 2001;*
- MASH* *Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara (SKPAK), Tiranë, Janar 2005.*
- MEDPAK* *Materiale të dokumentuara të projektit “Arsimi Special i Integruar” faza e parë 2000-2001, faza e dytë 2001-2002, 2002-2003;*
- Haxhiymeri, V & “Turku, A* *Raport-vlerësimi për veprimtarinë e projektit “Arsimi Special i Integruar” MEDPAK, UNICEF, dhjetor, 2003.*
- Closs, A., Nano, V. dhe Ikonomi, E.* *“Unë jam si ju” Botim i SAVE THE CHILDREN. Tiranë, 2003;*
- Nano, V.* *Shkolla Shqiptare Drejt Proceseve Integruese. Botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Tiranë, 2002;*
- QSHDDNJ* *Të drejtat e njeriut, Për mësuesit e shkollës 8-vjeçare, “Pozitron”Tiranë, 1996;*
- Dokumenta* *Edukimi i të Drejtave të Njeriut, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë, shtator2002;*
- Dokumenta* *Të drejtat e njeriut-Përmbledhje aktesh ndërkombëtare,Tiranë, 1993;*
- Fullan, M* *Forcat e ndryshimit, CDE; Pegi, Tiranë, 2002;*

GRUPI I STUDIMIT

Studimi u krye nga Zela Koka dhe Valentina Haxhiymeri (MA), Marita Nika Flagler (Ph. D), dhe Fatmir Bezate, raporti përfundimtar u shkrua nga Valentina Haxhiymeri (MA). Zela Koka është prind fëmije me aftësi të kufizuara që ka ndjekur arsimin e integruar special, mësuese e arsimit special të integruar në Librazhd dhe kyetare e shoqatës jofitimprurëse MEDPAK që ka iniciuar arsimin e integruar në Shqipëri. Valentina Haxhiymeri është pedagoge në Universitetin Pedagogjik “Aleksander Xhuvani” në Elbasan dhe autore e vlerësimit të projektit “Arsimi Special i Integruar”. Marita Nika Flagler është prind i një fëmije me aftësi të kufizuara që ka kryer arsimin e integruar. Ajo ka kryer studimet e masterit dhe doktoratës në SHBA, me specializim në degën e nevojave speciale dhe është shefe e departamentit të psikologjisë pranë Universitetit të Nju Jorkut në Tiranë. Intervistat në MASH u kryen nga Fatmir Bezati, i ngarkuar, ndërmjet të tjerave, edhe me ndjekjen e arsimit special në shkollë vendi. FSHDPAK me mbështetjen financiare dhe në bashkëpunim me Save The Children Albania ideuan dhe koordinuan realizimin e këtij studimi.

Zela Koka , Tel: 0682578002, e-mail: medpak@albmail.org

Valentina Haxhiymeri, Tel: 0692275728, e-mail: vxhafa@yahoo.com

Marita Nika Flagler , Tel: 0692773087, email: geldon@lamar.colostate.edu

Fatmir Bezati , Tel: 0692133369, e-mail: fbezati@mash.gov

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (FSHDPAK)

Rr. Mujo Ulqinaku, Nr 26, Tiranë

Tel +3554 266 892/ 269426/

e-mail: adrf@icc.al.eu.org/

www.adrf.org.al

SAVE THE CHILDREN - NË SHQIPËRI

Rr. Komuna e Parisit; L8, P 1 Maji, Vila Lami,

P.O. Box 8185 Tiranë

Tel: +355 4 2361840; 261929,266277

Fax +355 4 263428

e-mail: savealbania@savealbania.org

www.savealbania.org

THE WORKING GROUP

This research was carried out by Zela Koka and Valentina Haxhiymeri (MA), Marita Nika Flagler (Ph. D), and Fatmir Bezate. The final report was written by Valentina Haxhiymeri (MA). Zela Koka is a parent of a disabled child who has followed the specific integrated education. Mrs. Koka is a teacher of the special integrated education in Librazhd and the Chairwoman of the non-governmental association MEDPAK, which initiated the integrated education in Albania. Valentina Haxhiymeri is a professor at the Teachers University "Aleksander Xhuvani" in Elbasan and author of the evaluation report written on the project "Specific Integrated Education". Marita Nika Flagler is a parent of a disabled child who has completed the integrated education. She has a masters degree and doctoral degree specialized on special needs earned in the United States of America. She is Head of the Psychology Department at the University of New York in Tirana. Interviews at MES were carried out by Fatmir Bezati, who among other things is in charge of monitoring the progress of specific education at a national level. ADRF(FSHDPAK) with the financial support and cooperation of Save The Children Albania came up with the idea and coordinated their action in order to carry out this study.

Zela Koka , mobile no: 0682578002, e-mail: medpak@albmali.org

Valentina Haxhiymeri, mobile no: 0692275728, e-mail: vxhafata@yahoo.com

Marita Nika Flagler , mobile no: 0692773087, email: geldon@lamar.colostate.edu

Fatmir Bezati , mobile no: 0692133369, e-mail: fbezati@mash.gov

Albanian Disability Rights Foundation (ADRF)
Rr. Mujo Ulqinaku, Nr 26, Tirane
Phone no: +3554 266 892/269426/
e-mail: adrf@icc.al.eu.org/
www.adrf.org.al

SAVE THE CHILDREN - IN ALBANIA
Rr. Komuna e Parisit; L8, P I Maji, Vila Lami,
P.O. Box 8185 Tirane
Phone no: +355 4 2361840; 261929,266277
Fax +355 4 263428
e-mail: savealbana@savealbana.org
www.savealbana.org

- Cenaliu, L. How to identify and treat disabled children. *Psycho-Pedagogical and Social Problems* (pp. 63-72, Chap. 5). A publication of the Institution of Pedagogical Studies 2004)
- MES National Strategy on Children 2001-2005, The Convention on the Rights of Children, (20 November 1989), published in Tirana 2001;
- MES National Disability Strategy (SKPAK), Tirana, January 2005.
- MEDPAK Documented materials of the project "Specific Integrated Education" first phase 2000-2001, second phase 2001-2002, 2002-2003;
- Haxhiymiri, V & "Turku, A Evaluation report on the activities under the project "Specific Integrated Education" MEDPAK, UNICEF, December, 2003.
- Closs, A., Nano, V. "I am like you " Publication of SAVE THE CHILDREN. Tirana, 2003;
- Nano, V. The Albanian School Towards Inclusive Processes. A publication of The Albanian Disability Rights Foundation. Tirana, 2002;
- QSHDDNJ Human Rights, meant for the teachers of the 8-year compulsory school of "Pozitron" Tirane, 1996;
- Documents Education on Human Rights, the Albanian Center on Human Rights, Tirana, September 2002;
- Documents Human Rights – A summary of international acts, Tirana, 1993;
- Fullan, M. *Forces of Change, CDE; Pegi, Tirana, 2002;*

BOOKS OF REFERENCE



Save the Children

***ANALYSIS OF THE LEGAL FRAMEWORK
GUARANTEEING THE EDUCATION OF DISABLED CHILDREN
UNDER THE INCLUSIVE EDUCATION***

RESEARCH REPORT

Tirana, March 2005

*The Albanian Disability Rights Foundation, with the Support
and Cooperation of Save the Children, in Albania*

**ANALYSIS OF THE LEGAL FRAMEWORK
GUARANTEEING THE EDUCATION OF DISABLED
CHILDREN UNDER THE INCLUSIVE EDUCATION
RESEARCH REPORT**

*Regional experience, achievements,
suggestions and future challenges*

*This research was carried out by:
Zela Koka, MA. Valentina Haxhiymeri, Dr. Marita Nika Flagler, Fatmir Bezati*

*This report was prepared by:
Valentina Haxhiymeri*

Tirana, March 2005

Albanian Disability Rights Foundation (ADRF)

Rr. Mujo Ulqinaku, Nr 26, Tirane
Phone no: +3554 266 892/ 269426/
e-mail: [adrf@icc.al.eu.org/](mailto:adrf@icc.al.eu.org)
www.adrf.org.al

Save the Children - in Albania

Rr. Komuna e Parisit; L8, P 1 Maji, Vila Lami,
P.O. Box 8185 Tirane
Phone no: +355 4 2361840; 261929,266277
Fax +355 4 263428
e-mail: savealbania@savealbania.org
www.savealbania.org

Content

Introduction	5
1. The contemporary meaning of inclusive education and a historical overview of its application in the Albanian mainstream schools	7
2. The current legal framework guaranteeing the right of disabled children to education under the all-inclusive education	11
3. The project “Integrated Education” – “the laboratory” where the efficiency of the actual legal framework on all-inclusive education was tested	14
4. The current situation on the implementation of the legislation on inclusive education in the region of Librazhd and Elbasan	18
5. Thoughts of the education specialists on the efficient implementation of the law on inclusive education	38
6. Research conclusions	40
7. Intervention areas identified for a more efficient implementation of the legislation on inclusive education	43
8. Books of Reference	49
9. Research Group	50

INTRODUCTION

*One of the main requirements to be met by the aspiring countries to become a member of the European Community is **access to education of all children, without discrimination and regardless...of their disabilities**. The achievement of this requirement remains a great concern for the Albanian society. Despite the fact that our schools have been involved for years in a series of reforming processes, which continue to aim at dimensioning their educative functions and their gradual transformation into “all-inclusive” schools, still, the concrete results are far from being up to EU standards and requirements.*

Under these circumstances, the intensification of common efforts to fast forward and further deepen the all- inclusive reform in the education system means guaranteeing educational equality for all students, including the disabled ones, becoming thus an important and necessary task.

*Based on this idea, during the period of December 2004 to January 2005, the Albanian Disability Rights Foundation , financially supported by “Save the Children” undertook a regional study. Its main objective was to identify the actual steps to be taken in **the implementation of the legislation on education of disabled children within the framework of all-inclusive education**, as well as to identify **problems impeding its complete application**. This study was carried out in the area of Librazhd and Elbasan, where the well-known project “Special Integrated Education” recently terminated. It contributed in gaining the first experience in the education of disabled children with in the mainstream schools, which also resulted in the amendment of the legal framework guaranteeing the continuation of this experience.*

In order to achieve its goals, this study put in its objective not only the mainstream schools but other institutions as well which guide and support the education activities in these schools. Thus, part of this study focused on disabled students, their peers, their teachers, parents of disabled children, specialists of Psychological Service, School Principals, heads and inspectors of the RED and EO, SSO employees near the District Municipalities, professors and students of Teachers’ Departments at various Faculties, education specialists at the Ministry of Education and Science, etc. Since one of the main objectives of this research was to explore the possibility to implement this project in the capital of Tirana, it also included the Education Directorate of Tirana and the Social Service offices at the Municipality of Tirana as well.

The great range of subjects included in the research and their peculiarities regarding age, profession, role, education level and respective functions meant that the research group could use a great variety of approaches to collect the necessary information. In this context, the research group paid great attention to the approaches used in its research in order for them to comply with the specific objectives of this research and the characteristics of our subjects based on their particular age group. The most common approach used with disabled children during this research was their observation in the classrooms and while in the schoolyard, their participation in group conversations, and also performance in academic assignments and various drawing tasks. The approach of interviewing the disabled children was used far less than the abovementioned approaches. While the method of research used with their normal peers was observation, drawing tasks and questionnaires. Survey questionnaires and direct or phone interviews were used with teachers, parents, psychologists, school principals, students and academic staff at the University of Elbasan.

The same approach was also used with the inspectors at the RED, EO, SSO and MES. After the presentation our findings and the data collected in percentage followed by the analytical consideration of documented facts, the research ends up in a written report.

The content of this report follows the logical line of the research itself. It consists of three important parts. The first part explains the contemporary meaning of the all-inclusive education; it gives a historical overview of its application in the Albanian mainstream schools, and the amendments of the legal framework guaranteeing the education of disabled children under the conditions of the all- inclusive education that followed. This served as the theoretical basis for this research and emphasizes the fact that in Albania there exists a successful experience in all-inclusive education and a complete legal framework that guarantees the continuation of this experience. The second part of this research attempts to answer the questions on the current situation in mainstreaming the disabilities into the wider education system and the extent to which the legislation on all-inclusive education is applied. This part endeavors to accomplish the main objective of this research and it presents an elaborate fact-based analysis on the problems faced by the mainstream schools in implementing the legislation on education of disabled children under the all- inclusive education.

The preliminary conclusions of this part of the research were topics for discussions at a round table held with education specialists at an expert level. This round table led to the achievement of the ultimate goal of this research: the determination of intervention areas in order to increase the efficient implementation of legislation on all- inclusive education. This issue also marks the final part of the report followed by modest recommendations on necessary changes in the future.

